



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Teknik Laboratori”

ofruar nga

Universiteti “Western Balkans”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Edit Xhajanka

Prof. Dr. Etleva Refatllari

Tetor/2025

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@askal.al

Web site: www.askal.al

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Teknik Laboratori"**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Western Balkans" (WBU)
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Teknik Laboratori"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS nr. 441, datë 20.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe/angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë) në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Për vitin akademik: 2024-2025: 26 PAE/ 6 PAK. 2023-2024: 20 PAE/ 10 PAK 2022-2023: 17 PAE/ 5 PAK
18	Numri i studentëve:	11 studentë v.a. 2022-2023 (vetëm Anglisht) 17 studentë v.a. 2023-2024 (11 gjuhë Shqipe/ 6 Anglisht) 13 studentë v.a. 2024-2025 (6 gjuhë Shqipe/ 7 Anglisht)
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Western Balkans" (WBU) është një institucion i ri në fushën e arsimit të lartë në Shqipëri, me fokus të veçantë në Mjekësi, Shkencë Mjekësore, Teknologji, Ekonomi dhe Inovacion. WBU është hapur me VKM nr. 678 datë 10.12.2021. WBU është organizuar në përputhje me ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në aktet e tjera nënligjore lidhur me arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. WBU ka marrë akreditimin e parë institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 75, datë 19.04.2024 për një periudhë 6 vjeçare. Aktualisht WBU është organizuar në 3 fakultete (Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike; FSHMT, Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit) dhe ofron 20 programe studimi:


FSHMT në WBU organizohet në katër departamente dhe një qendër kërkimore: Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri (DSHLMI), Departamenti i Mjekësisë, Departamenti i Kirurgjisë, Qendra kërkimore për studimin e sëmundjeve të rralla. FSHMT në WBU ofron shtatë programe studimi në fusha specifike të shkencave mjekësore – teknike (Katër programe Bachelor, një program Master i Shkencav, Dy programe të integruara të ciklit të dytë).

Programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" ofrohet nga DSHLMI. Ai u miratua si program i ciklit të parë të studimeve me VKM Nr. 679, datë 10.11.2021. Ky program është hartuar dhe ofrohet në përputhje me planet e zhvillimit strategjik të institucionit dhe në përputhje me fushën akademike të FSHMT dhe DSHLMI përgjegjës për këtë program studimi.

Programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" është organizuar dhe strukturuar në përputhje me statusin dhe rregulloret e institucionit, Ligjin 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe akteve nënligjore në fuqi për IAL-të. Ai është program i ciklit të parë të studimeve dhe korrespondon me Nivelin 6 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Programi zhvillohet me kohë të plotë, organizohet në lëndë e module të vlerësuara në ECTS. Programi ka një shtrirje në 3 vite akademike (6 semestra) dhe vlerësohet me 180 ECTS të shpërndara uniformisht gjatë 3 viteve.

Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri që ofron programin e studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" përmbush kërkesat ligjore, standartet e cilësisë së stafit akademik dhe standartet infrastrukture për ofrimin e tij.

Programi synon të pregatisë infermierë të aftë për të përmbushur nevojat e sistemit shëndetësor në Shqipëri duke integruar pregatitjen profesionale me edukimin e vlerave si fryma e bashkëpunimit, etika profesionale, përgjegjësi sociale, integriteti njerëzor dhe profesional, respekti, llogaridhënia, përgjegjësi, diversiteti. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës vendas dhe më gjerë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit të studimit Bachelor në “Teknik Laboratori”, i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore teknike në WBU. Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kriterëve për programin e studimit, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kriterëve respektive. [ascal.al]

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit; Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat; Burimet njerëzore financiare infrastruktura logjistika për realizimin e programit të studimit; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen
- Standardet përmbushen pjesërisht
- Standardet përmbushen kryesisht
- Standardet përmbushen plotësisht

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjyqimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Dokumentacioni i referuar listohet për çdo kriter dhe standard (Evidencat).

Proçesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof. Dr. Edit Xhajanka dhe Prof. Dr. Etleva Refatllari. Koordinator Teknik i ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Rajna Lila.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, proçesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.

- Vizita në WBU e zhvilluar në datat 10 – 11 Prill 2025. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e WBU.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Universiteti "Western Balkans", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 26.09.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 24 / 36 Prot, datë 26.09.2025. Universiteti "Western Balkans", njofton në ASCAL më datë 08.10.2025, me anë të shkresës me Nr.634/1 Prot, datë 08.10.2025 "Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Teknik Laboratori”.

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Western Balkans” (WBU) është një institucion i ri në fushën e arsimit të lartë në Shqipëri, me fokus të veçantë në Mjekësi, Shkenca Mjekësore, Teknologji, Ekonomi dhe Inovacion. WBU është hapur me VKM nr. 678 datë 10.12.2021. WBU deklaron në statut se është organizuar në përputhje me ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet e tjera nënligjore lidhur me arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. WBU synon të ketë një ndikim transformues në shoqërinë shqiptare përmes inovacionit të vazhdueshëm në arsim, kërkim, kreativitet dhe sipërmarrje. Misioni i universitetit i shprehur në nenin 3 të Statutit është formimi i profesionistëve të së ardhmes, në dobi të individit dhe shoqërisë, duke synuar të jetë një nxitës i zhvillimit ekonomik dhe shëndetit, duke promovuar progresin dhe inovacionin në Shqipëri dhe në rajon. Ky mision natyrisht synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. WBU synon të bëhet burim i çmuar mundësish për shoqërinë në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe ekonomisë. WBU ka marrë akreditimin e parë institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 75, datë 19.04.2024 për një periudhë 6 vjeçare. Aktualisht WBU është organizuar në 3 fakultete: • Fakulteti i Mjekësisë Dentare • Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike • Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit Megjithëse strukturë e re universitare, në vizionin e zhvillimit, WBU ka në fokus t’u ofrojë studentëve dhe shoqërisë një qendër edukimi që integron plotësisht tre drejtimet bazë të procesit akademik: mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe përgjegjësinë sociale. Në funksion të kërkimit shkencor në WBU janë krijuar: • Qendra Kërkimore për Cilësinë dhe Sigurinë e Kujdesit të Shëndetit Oral

	• Qendra Kërkimore për Studimin e Sëmundjeve të Rralla Bashkëpunimet dhe partneritetet e WBU me institucione akademike, qendra spitalore etj. sigurojnë një kurrikul vizionare që i përgjigjet sfidave globale dhe përgatit studentët për të qenë të suksesshëm në një botë pa barriera. WBU ofron në tërësi 20 programe studimi: • 3 programe të integruara të ciklit të dytë • 14 programe Bachelor • 3 programe Master i Shkencave Programet e studimit të ofruara nga WBU janë në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike të WBU nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ky program studimi është në përputhje me misionin e Universitetit dhe synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. <i>(Evidencat 1.1 Statuti i WBU, 1.2 Rregullorja themelore e WBU, 1.3 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, 2 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Teknik Laboratori", Faqja web e WBU)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit dhe fushën e veprimtarisë. Ai ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT) në WBU. Misioni i fakultetit është edukimi dhe trajnimi i studentëve të shkencave mjekësore teknike në fushat përkatëse, në përputhje me standardet më të larta profesionale si dhe përgatitja e tyre për të ofruar kujdes shëndetësor me standardin më të lartë ndaj pacientit. Në mënyrë specifike, programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" përgatit specialistë të fushës së mjekësisë laboratorike, profesionistë me një rol të rëndësishëm në çdo ekip mjekësor për diagnozën, trajtimin e parandalimin e sëmundjeve, me një kontribut të qartë në cilësinë e kujdesit shëndetësor. FSHMT në WBU organizohet në katër departamente dhe një qendër kërkimore. • Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë • Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri • Departamenti i Mjekësisë • Departamenti i Kirurgjisë • Qendra kërkimore për studimin e sëmundjeve të rralla



	FSHMT në WBU ofron shtatë programe studimi në fusha specifike të shkencave mjekësore – teknike: • Katër programe Bachelor 1. Bsc. në teknik Laboratori (shqip/anglisht) 2. Bsc. në teknik Imazherie (shqip/anglisht) 3. Bsc. në Infermieri (shqip/anglisht) 4. Bsc. në Fizioterapi (shqip/anglisht) • Një program Master i Shkencave 1. Msc. Në Infermieri me pesë profile • Dy programe të integruara të ciklit të dytë 1. Program i integruar në Mjekësi 2. Program i integruar në Farmaci Programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" ofrohet nga Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri. Ai u miratua si program i ciklit të parë të studimeve me VKM Nr. 679, datë 10.11.2021. Programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" kategorizohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. <i>(Evidencat 1.1 Statuti i WBU, 1.3 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri, 1.6 Struktura organizative e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Tabela 3 e RVB)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	WBU dhe FSHMT, ofruet të programit të studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" e bazojnë veprimtarinë e tyre në Statutin dhe rregulloret e institucionit. Mbështetur në këto dokumenta bazë të funksionimit të institucionit hartohen rregulloret e programeve të studimit dhe strategjitë e zhvillimit. Institucioni ka publikuar dokumentin e planit strategjik për vitet 2023 – 2030 një plan ambicioz i projektuar si "Rruga drejt Ekselencës". WBU synon t'u japë studentëve njohuritë, aftësitë dhe burimet që u nevojiten për të ndjekur karriera domethënëse dhe rritje profesionale. Vizioni i WBU nuk fokusohet vetëm në ekselencën akademike. Ai synon të jetë partner aktiv në bashkëpunim me industrinë, institucionet qeveritare dhe qendrat kërkimore për krijimin e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukture të nivelit ndërkombëtar për të lehtësuar zbatimin e projekteve kërkimore ndërdisiplinore në teknologji dhe inovacion, të integruara me shkencat mjekësore, shkencat e jetës dhe ekonominë. Kurrikula e programit bachelor në "Teknik Laboratori" ofron një arsim multidisiplinar ku theksohet aftësia e komunikimit,

	kërkimit dhe zgjidhjes së problemeve kërkimore. Programi u jep studentëve njohuri teorike dhe praktike në të gjitha fushat e patologjisë klinike si kimia klinike, hematologjia laboratorike, bakteriologjia, parazitologjia, virologjia, mykologjia, imunologjia, histologjia, transfuzioni dhe mjekësia eksperimentale dhe bërthamore. Programi synon të pregatisë specialistë të aftë në përdorimin e teknikave të avancuara dhe kryerjen e eksperimenteve të standardeve të larta në çdo laborator modern. Programi synon gjithashtu edukimin e vlerave etike dhe njerëzore të domosdoshme për rritjen e cilësisë së shërbimit mjekësor. <i>(Evidencat 1.1 Statuti i WBU, 1.3 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri, 1.5 Plan strategjik i WBU 2023 - 2030, Faqja web e WBU)</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	GVJ konstaton se Programi Bachelor në "Teknik Laboratori" ofrohet në një institucion të ri universitar, me infrastrukturë moderne, burimet dhe kapacitetet e duhura për realizimin e programit të studimit. Vlerësimi i GVJ u mbështet në konsultimin e dokumentacionit të dorëzuar, në takimet me stafin dhe vizitën në ambientet e mësimdhënies. Në tabelat shoqëruese të RVB si dhe në CV e personelit akademik jepet një informacion i detajuar mbi numrin dhe cilësitë e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit. Në këtë fakultet aktivizohen një numër optimal personeli akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK), si dhe personel ndihmës akademik (PNA), specialistë të fushave që mbulon secili departament: Viti akademik 2024 – 2025 • PAE 43, të kategorive: 2 Prof., 1 Prof. Asc., 17 Dr., 23 Msc. • PAK 22, të kategorive: 2 Dr., 20 Msc. • PNA 1 Viti akademik 2023 – 2024 • PAE 36, të kategorive: 1 Prof., 4 Prof. Asc., 15 Dr., 16 Msc. • PAK 40, të kategorive: 1 Prof., 2 Prof. Asc., 7 Dr., 30 Msc. • PNA 2 Viti akademik 2022 – 2023

	• PAE 26, të kategorive: 3 Prof. Asc., 10 Dr., 13 Msc. • PAK 12, të kategorive: 4 Dr., 8 Msc. • PNA 2 Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri që ofron programin e studimit angazhon në mësimdhënie personel akademik me kualifikim kryesisht të fushës së mjekësisë, biologjisë, kimisë, bioteknologjisë të shpërndarë në vite si më poshtë. Viti akademik 2024 – 2025 • PAE 13, të kategorive: 5 Dr., 8 Msc.(3 me specializim pasuniversitar SPA) • PAK 14, të kategorive: 1 Prof. Asc., 2 Dr., 11 Msc. (3 me SPA) Viti akademik 2023 – 2024 • PAE 8, të kategorive: 3 Dr., 5 Msc. (3 me SPA) • PAK 11, të kategorive: 3 Prof. Asc., 2 Dr., 6 Msc. Viti akademik 2022 – 2023 • PAE 8, të kategorive: 4 Dr., 4 Msc. (3 me SPA) • PAK 1, të kategorive: 1 Dr. GVJ konstaton se ka një përmirësim të kapaciteteve akademike në vijimësinë 3 vjeçare të programit të studimit. Në takim me drejtuesit e institucionit dhe stafin akademik u theksua mbështetja që institucioni i siguron stafit për kualifikim, punime shkencore për fitimin e titujve dhe gradave për të plotësuar në të ardhmen plotësisht kërkesat ligjore për stafin akademik. Infrastruktura laboratorike është e plotë për realizimin e programit të studimit. Laboratorët e biokimisë, mikrobiologjisë, biologjisë molekulare, anatomisë, histopatologjisë u inspektuan nga GVJ. Laboratorët ishin të paisur në përputhje me kurrikulën e programit dhe të organizuar mjaft mirë për punën me studentët. Institucioni ka marrëveshje aktive bashkëpunimi me Spitalin Amerikan, Spitalin Hygeia dhe laboratorët Cambridge për realizimin e praktikave profesionale. Në dispozicion të studentëve janë dhe ambientet e bibliotekës që u vizituan nga GVJ. <i>(Evidencat 1.7, 1.8, 1.11 Marrëveshjet e bashkëpunimit, Tabelat 1, 6, 7, 8, 16, 17 të RVB, CV e personelit akademik, vizita dhe takimet në institucion)</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe	Programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" është program që përgatit profesionistë të mjekësisë me fushë

specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	veprimi në shërbimin diagnostik. Programi synon që të diplomuarit e këtij programi të punojnë lehtësisht në çdo laborator modern dhe do të jenë në gjendje të punojnë si: • Teknik laborator në biokimi (Laborator i institucioneve shëndetësore parësore, dytësore dhe terciare) • Teknik laborator në mikrobiologji • Teknik laborator në diagnozën molekulare • Teknik laborator në patologji • Teknik laborator në imunologji • Teknik laborator në hematologji • Teknik laborator në histologji Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit përputhet plotësisht me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamentit të Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri, përgjegjëse për programin e studimit. GVJ vlerëson se programi i studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” është organizuar dhe strukturuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit duke respektuar kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. • Programi kategorizohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve • Emërtimi përputhet me fushën specifike të studimit • Strukturohet në 6 semestra akademikë (secili me 30 ECTS) • Në ndarjen e lëndëve janë respektuar kriteret ligjore në fuqi (VKM 41 datë 24.01.2018, i përditësuar) • Programi i studimit është i kodifikuar në përputhje me urdhërat dhe udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin: Kodi i programit është 63BA0914S për programin në shqip dhe 63BA0914A për programin në anglisht. • Lëndët e programit të studimit janë të koduara sipas përcaktimeve ligjore. <i>(Evidencat 1.1 Statuti i WBU, 1.3 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri, 2.4 Njoftim Nr. 7381/15 datë 30.12.2024 për kodifikimin e programit të studimit)</i>
Konkluzione	GVJ gjykon se programi i studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit dhe në përputhje të plotë me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamentit

	të Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri që janë përgjegjëse për këtë program studimi. Programi i studimit synon formimin e specialistëve të aftë për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të ofruar shërbim në të gjitha nivelet dhe tipologjitë e strukturave laboratorike mjekësore. Programi synon të pregatisë studentët me kapacitete të mjaftueshme teoriko-praktike për të vazhduar studime të mëtejshme dhe kërkim shkencor. Programi është në përputhje me strategjinë kombëtare në fushën e shëndetësisë dhe synon të përmbushë nevojat specifike për personel të pregatitur në kushtet e revolucionit teknologjik në sistemet laboratorike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	FSHMT në WBU ofron 7 programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në fushën e mjekësisë. Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri është përgjegjës për këtë program studimi. Për realizimin e këtij programi departamenti ka angazhuar PAE dhe PAK. Në realizimin e programit të studimit përfshihen dhe stafi ndihmës dhe administrativ i WBU. Organizimi i strukturave realizuese të programit është piramidal dhe funksionon me parimin e bashkëpunimit dhe kontrollit. GVJ u njoh me dokumentacionin e gjerë të vënë në dispozicion mbi aktet rregullatore për ndarjen e detyrave dhe funksionimin e personelit akademik, administrativ dhe ndihmës në funksion të programit të studimit. Aktet rregullatore janë statuti dhe rregulloret e detajuara të institucionit, njësisë kryesore, njësisë bazë dhe rregullorja e programit të studimit. Institucioni ka ndërtuar planin strategjik të zhvillimit realizimi i të cilit monitorohet nga strukturat drejtuese të tij. Për realizimin e programit të studimit institucioni ka lidhur gjithashtu marrëveshje me institucione mjekësore për realizimin e praktikave mësimore. Dekanati koordinon orarin mësimor dhe ngarkesës mësimore të stafit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	akademik midis njësive bazë të FSHMT si dhe të institucioneve shëndetësore ku realizohet praktika profesionale në funksion të realizimit të programit mësimor në këtë program studimi. Institucioni bën analizë të vazhdueshme të punës që pasqyrohet në Raportin vjetor të Departamenteve dhe raportin vjetor institucional. NJSBC jep kontribut në analizën e vazhdueshme të punës përmes grumbullimit dhe analizimit të informacionit mbi aspekte të ndryshme të aktivitetit akademik. <i>(Evidencat 1.1 Statuti i WBU, 1.2 Rregullorja themelore e WBU, 1.3 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri, 1.5 Plani strategjik i WBU 2023 – 2030, Tabelat 3 dhe 5 të RVB)</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të programit Bachelor në “Teknik Laboratori”, WBU ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda vendit, institucione spitalore dhe laboratorë si dhe me institucione homologe jashtë vendit. Në dokumentin e strategjisë së zhvillimit institucional, WBU ka përcaktuar qartë politikat e tij të bashkëpunimit duke u fokusuar në një pikë të veçantë në partneritet dhe ndërkombëtarizim. Bashkëpunimet me laboratorët spitalorë të Spitalit Amerikan dhe Hygeia si dhe rrjetin e laboratorëve Cambridge kanë mundësuar realizimin e objektivave të procesit mësimor – formues. Ky bashkëpunim ka ndikuar dhe në nxitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve shkencore dhe aplikimin për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Në takimin me pedagogët dhe studentët u informuam për angazhimin e studentëve të këtij programi me pedagogen A. Daka në një studim për sindromin metabolik. <i>(Evidencat 1.5 Plani strategjik i WBU 2023 – 2030, 1.7 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, 1.8/1.11 Marrëveshjet me spitalin Amerikan, spitalin Hygeia dhe laboratorët Cambridge, 1.12 Lista e marrëveshjeve EPIC, Tabela 5 e RVB, takimet në institucion)</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të	Programi Bachelor në “Teknik Laboratori” është një program i gjerë, i dedikuar në diagnozë, monitorim, parandalim që pajis studentin me aftësi për të punuar në laboratorë biokimikë, hematologjikë, mikrobiologjikë, anatomopatologjike etj. Pë realizimin e praktikës shumëplanëshe në funksion të programit WBU ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione

fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	partnere (laboratorët e Spitalit Amerikan dhe Hygeia si dhe rrjetin e laboratorëve Cambridge) të cilët ofrojnë një teknologji të përparuar laboratorike, janë të akredituar dhe menaxhohen përmes hierarkisë dhe kontrollit. Në vizionin e tij, WBU synon të jetë universiteti i gjeneratës së katërt ku përveç formimit akademik cilësor në auditor, kërkimit shkencor të thelluar dhe përdorimit të frutshëm të njohurive të fituara, universiteti synon të jetë pjesë proaktive e zhvillimit ekonomik në vend e më gjerë. Në këtë kuadër, WBU është përfshirë në programin EPIC (educatin-practice integrated curriculum)përmes të cilit studentët kryejnë praktika të paguara (internship) pranë institucioneve partnere. Përmes këtij programi universiteti mbështet dhe inkurajon studentët me arritje akademike të larta. Në dokumentacion evidentuam se 14 studentë të programit Bachelor në “Teknik Laboratori” kanë përfituar nga programi EPIK gjatë 2 viteve akademike 2022 – 2023 dhe 2023 – 2024. <i>(Evidencat 1.7 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, 1.8/1.11 Marrëveshjet me spitalin Amerikan, spitalin Hygeia dhe laboratorët Cambridge, 1.12 Lista e marrëveshjeve EPIC, 1.13 Manualët e praktikave EPIC)</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Në mënyrë periodike, Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri, përgjegjëse e programit të studimit harton raporte analitike për përfitimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Ky raport siguron informacion lidhur me ndikimin e këtyre marrëveshjeve në bashkëpunimin midis personelit akademik dhe studentëve për shkëmbim eksperience, kërkim shkencor, mobilitet etj. Të dhënat e raporteve shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, hartimin e politikave të zhvillimit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Raportet diskutohen në mbledhjet e analizës vjetore ku jepen dhe rekomandime për përmirësimin e punës në të ardhmen. Tërësia e rekomandimeve përkthehet në objektiva të planit strategjik të institucionit. <i>(Evidencat 5.21 Raporti vjetor i DSHMLI, 1.5 Plani strategjik 2023 – 2030)</i>
Konkluzione	WBU e ka ndërtuar aktivitetin për hartimin, implementimin dhe monitorimin e programit të studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” bazuar në një kuadër të plotë rregullator sipas kërkesave që burojnë nga Ligji i Arsimit të Lartë.

	<i>Për realizimin e objektivave formues të programit të studimit dhe për plotësimin e shprehive praktike profesionale, institucioni ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione spitalore, dhe laboratorë përmes të cilave siguron realizimin e praktikave për studentët e këtij programi studimi me qëllim përgatitjen e specialistëve të aftë për të shërbyer në të gjitha fushat e laboratorëve mjekësorë.</i> <i>Institucioni ka lidhur marrëveshje me institucione universitare jashtë Shqipërisë që i shërbejnë jo vetëm aftësisht profesional të stafit dhe studentëve por janë dhe në funksion të kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit European të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit. Referuar rregullores së programit të studimit, planit mësimor dhe RVB: • Programi Bachelor “Teknik Laboratori” është program i ciklit të parë të studimeve dhe korrespondon me Nivelin 6 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

	- Programi i studimit është organizuar në lëndë/module sipas kriterëve ligjore në fuqi: ligji i arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr.41 datë 24.01.2018. - Programi organizohet në formën e studimit me kohë të plotë. - Kohëzgjatja e studimeve është 3 vite akademike/6 semestra. Çdo semestër ka 16 javë. - Vlerësimi në kredite: 180 ECTS (4500 orë) të ndara 60 ECTS për vit akademik (1500 orë). 1 ECTS = 25 orë mësimore dhe punë e pavarur e studentit. - Raporti ECTS: orë është 1 ECTS = 25 orë (Raporti 10/15 orë në auditor/orë studimi individual). Kohëzgjatja e orëve të mësimi është 50 minuta. - Programi i studimit është i organizuar në lëndë/module të ndara në kategori dhe të prezantuara në planin mësimor dhe tabelat e RVB. - Viti I: 15 lëndë teorike + praktikë laboratorike (semestri 2) - Viti II: 15 lëndë teorike + praktikë laboratorike (semestri 2) - Viti III: 11 lëndë teorike + praktikë laboratorike (semestri 2) + Provimi i formimit/Tema e Diplomës Proçesi mësimor në auditor përmban elementë të mësimi teorik, (leksione, seminare) dhe praktik (laboratorë, praktikë profesionale). Referuar llogaritjeve në planin mësimor (Evidenca 2.2), orët totale janë 4500. Prova finale në planin mësimor ka 6 ECTS dhe 150 orë të organizuara në 30 orë në auditor (seminare) dhe 120 orë punë e pavarur. <table border="1"> <thead> <tr> <th>Bsc "Teknik laborator" "</th><th>Në total</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Në auditor</td><td></td></tr> <tr> <td>- Leksione</td><td>1020</td></tr> <tr> <td>- Seminare</td><td>480</td></tr> <tr> <td>- Laboratore</td><td>285</td></tr> <tr> <td>- Praktika</td><td>225</td></tr> <tr> <td>Punë e pavarur e studentit</td><td>2490</td></tr> <tr> <td>Gjithsej</td><td>4500</td></tr> </tbody> </table> - Frekuentimi i orëve është i detyrueshëm në masën 75% për orët e leksioneve, 80% për orët e laboratorëve dhe praktikave.	Bsc "Teknik laborator" "	Në total	Në auditor		- Leksione	1020	- Seminare	480	- Laboratore	285	- Praktika	225	Punë e pavarur e studentit	2490	Gjithsej	4500
Bsc "Teknik laborator" "	Në total																
Në auditor																	
- Leksione	1020																
- Seminare	480																
- Laboratore	285																
- Praktika	225																
Punë e pavarur e studentit	2490																
Gjithsej	4500																

	- Referuar rregullores së programit të studimit, sezonet e provimeve zhvillohen në fund të çdo semestri. Rregullorja lejon zgjatje të sezonit të provimeve me vendim senati. - Rregullorja e programit të studimit përcakton Provimin si formën kryesore të vlerësimit të nivelit të njohurive të fituara nga studenti gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik. Referuar syllabuseve të lëndëve, provimi përfundimtar zë 40 – 70% të pikëve totale të vlerësimit (në varësi nga tipologjia e lëndës). - Në rregulloren e programit të studimit evidentohet forma e vlerësimit përfundimtar me provim ose temë diplome. Me vendim senati Nr.3 datë 07.11.2024 është vendosur që studentët e programeve të ciklit të parë, Bachelor të FSHMT do të diplomohen duke iu nënshtruar provimit përfundimtar. <i>(Evidencat 3.1 Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë”, 2.2 Kurrikula e programit të studimit, 2.3 Vendim senati për provimin përfundimtar, Syllabuset, Tabelat 9 dhe 10 të RVB)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” synon formimin e specialistëve kompetentë për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e profesionit në mjedisin dinamik të diagnostikës mjekësore laboratorike në kushtet e një zhvillimi të shpejtë teknologjik. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës. Kurrikula e programit të studimit ofron një edukim multidisiplinar. Programi i studimit realizohet në 44 lëndë/module të cilat ofrojnë informacion teoriko-praktik të gjerë në fushën e diagnostikës laboratorike. Në vitin e parë studenti merr njohuri në lëndë bazë (anatomi, fiziologji, kimi organike dhe inorganike, shkrim akademik, psikologji mjekësore), në lëndë kaakterizuese që japin një orientim teorik dhe metodologjik për disiplina të ndryshme profesionale (biokimi mjekësore, histologji, mikrobiologji, embriologji, citogjenetikë), lëndë ndërdisiplinore si fizika dhe elemente të sigurisë në punë. Tërësia e informacionin e përgatit studentin për të aplikuar njohuritë në kushte praktike në orët e praktikës laboratorike. Në dy vitet e tjera, programi synon aftësimin teoriko-praktik të studentëve në fushat e gjera të aplikimit të diagnostikës

Q. Stafa

	laboratorike si biokimia klinike, hematologjia, mikrobiologjia, anatomia patologjike, urgjenca mjekësore etj. Studenti merr informacion teoriko-praktik dhe për aspekte teknologjike të automatizimit dhe kontrollit të cilësisë, fusha shumë të rëndësishme për organizimin dhe funksionimin e një laboratorit modern. Një vend të rëndësishëm në programin mësimor ze praktika laboratorike e cila i krijon mundësi studentit të ballafaqojë njohuritë e marra në auditor me realitetin praktik diagnostik-terapeutik. Kryerja e praktikës në laboratorët spitalorë me të cilët WBU ka marrëveshje bashkëpunimi i prezanton studentët me aktivitete direkte laboratorike. Programi në tërësi jep njohuri të përparura në fushën e studimit dhe përgatit specialistë që konkurojnë denjësisht në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar. Programi i studimit ka një ndërthurje harmonike të koncepteve teorike me praktikën në auditor dhe praktikën profesionale. Studentët që diplomohen në këtë program studimi janë të aftë të punojnë në fusha të ndryshme të diagnostikës laboratorike në të gjitha tipologjitë e laboratorëve mjekësorë. Në diskutimin me studentët me raste konkrete për testime laboratorike të veçanta, për gabimet preanalitike dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre, GVJ vlerësoi reagimin e studentëve për saktësinë dhe kompetencën. <i>(Evidencat 2 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Teknik Laboratori", 2.2 Kurrikula e programit të studimit, Syllabuset, Tabelat 9 dhe 10 të RVB, takimi me studentët)</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Referuar tabelës 9 të RVB dhe planit mësimor, GVJ vlerëson se programi përmban të gjithë elementët sipas strukturës së përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Sipas planit mësimor, programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në: • Kategoria A: Lëndë bazë 36 ECTS ose 20% (standardi 15 – 20%) • Kategoria B: Lëndë karakterizuese 92 ECTS ose 51.11% (standardi 50 – 55%) • Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese 24 ECTS ose 13.33% (standardi 12 – 15%) • Kategoria D: Lëndë plotësuese 22 ECTS ose 12.22% (standardi 10 – 15%)

	Kategoria E: Detyrime përmbyllëse 6 ECTS ose 3.33% (standardi 3 – 5%) GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese përputhet me tipologjinë e lëndëve dhe përmbyllësitë e standartit. Mësimdhënia organizohet në leksione, seminare, laboratore, praktika, projekte etj. <i>(Evidencat 2 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Teknik Laboratori”, 2.2 Kurrikula e programit të studimit, Syllabuset, Tabelat 9 dhe 10 të RVB)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Në planin mësimor konstatohet se praktika profesionale realizohet në semestrin e dytë të çdo viti. - Në vitin e parë 3 ECTS - Në vitin e dytë 4 ECTS - Në vitin e tretë 4 ECTS Praktika profesionale zhvillohet në institucionet publike apo private me të cilat WBU ka marrëveshje bashkëpunimi sipas programit të detajuar në syllabusin e praktikës profesionale. Praktika vlerësohet me notë. 50% e pikëve të vlerësimit merren nga puna në laborator, 50% sigurohen nga provimi i ndërmjetëm (20%) dhe provimi përfundimtar (30%). Rregullorja themelore e WBU dhe rregullorja e programit të studimit përshkruajnë kushtet e diplomimit të studentëve. Në nenin 105 të rregullores themelore të WBU theksohet se për t’u paisur me diplomë, studenti duhet të ketë përmbyllur detyrimet e frekuencimit dhe të ketë marrë provimet në të gjitha lëndët me vlerësim nga A në E dhe të ketë mesatare mbi 7. GVJ diskutoi me drejtuesit dhe stafin akademik për kushtin e mesatares për diplomim si një kriter jo i zakonshëm në arsimin e lartë shqiptar. Në diskutime drejtuesit e WBU e vunë theksin në kërkesën për cilësi dhe adaptimin në funksion të cilësisë të kësaj praktike të njohur në disa institucione ndërkombëtare. Në planin mësimor përcaktohen 6 ECTS për detyrimet përmbyllëse të organizuara në 30 orë seminare në auditor dhe 120 orë punë e pavarur. Për të orientuar studentët në pregatitjen e provimit apo zgjedhjen e një teme diplome, departamenti ka pregatitur dhe “Manualin për punimin e diplomës”. Me vendim senati Nr.3 datë 07.11.2024 është vendosur që studentët e programeve të ciklit të parë, Bachelor të FSHMT do të diplomohen duke iu nënshtruar provimit përfundimtar.

	<i>(Evidencat 1.2 Rregullorja themelore e WBU, 2 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Teknik Laboratori", 2.2 Kurrikula e programit të studimit, Syllabuset, 2.3 Vendim senati për provimin përfundimtar, 3.27 MAnuali për punimin e diplomës, Tabelat 9 dhe 10 të RVB, takimet me drejtuesit dhe stafin)</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Kriteri nuk aplikohet (N/A)! Programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" nuk i përket programeve me status të veçantë. WBU aplikon sistem financimi për studentë të kategorive të veçanta dhe studentët e ekselencës mbështetur dhe në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe VKM 780, datë 26.12.2018. <i>(Evidencat 5.9 Marrëveshja me perspektivat e reja për bursat, 5.10 Rregullore e bursave, 5.11 Lista e studentëve përfitues të bursave)</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Në RVB theksohet se programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" në WBU ka ngjashmëri me programe të të njëjtës fushë. Në dokumentacion nuk ka evidenca konkrete por në diskutim me stafin drejtues dhe GVB ekspertët u informuan se programi ka ngjashmëri në përmbajtje me programin me të njëjtën emërtesë të ofruar nga Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Në përgatitjen e programit të studimit institucioni ka patur në konsideratë dhe programe të ngjashme ndërkombëtare. Ofrimi i programit edhe në gjuhën angleze krijon mundësi për mobilitet në programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit si dhe ka shtuar interesin e studentëve të huaj duke konkretizuar aspekte të ndërkombëtarizimit të institucionit. <i>(Evidencat RVB, Takimi me drejtuesit e njësive kryesore dhe njësive bazë të programit të studimit dhe GVB)</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në RVB deklarohet se Programi i studimit është kodifikuar nga vetë institucioni duke u bazuar në direktivat ndërkombëtare. Me shkresën Nr. 7381/15 datë 30.12.2024 "Për kodifikimin e programeve të studimit" Ministria e Arsimit ka konfirmuar kodet e programit Bachelor në "Teknik Laboratori" 63BA0914S për programin në shqip dhe 63BA0914A për programin në anglisht.

Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Për këtë program studimi është kryer dhe kodifikimi i lëndëve pasqyruar në syllabuset përkatëse. <i>(Evidenca 2.4 Kodifikim i programit të studimit, Syllabuset e lëndëve, RVB)</i>			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Kriteri nuk aplikohet. Programi i studimit nuk ofrohet si program i përbashkët.			
Konkluzione	Programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit European të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin dhe rregulloret e universitetit. Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e profesionit. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës. Pranimi, regjistrimi i studentëve dhe financimi në programet e studimit të WBU bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kapacitetet pritëse dhe kuotat e pranimi për çdo program studimi përcaktohen me vendim senati. Institucioni deklaron se Programi është i kodifikuar dhe krijon mundësi për mobilitet dhe ndjekje të mëtejshme të studimeve të ciklit të dytë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit	UWB është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, date 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"

përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

dhe Statutin e tij dhe zhvillon aktivitetin e tij në selinë në Tiranë.

Institucioni përbëhet nga organet akademike që janë senati akademik, asambleja e stafit akademik, komisionet e përhershme dhe autoritet akademike (rektori, dekanët, drejtuesit e njësive bazë); organe administrative që janë bordi i administrimit, administratori i universitetit, njësive kryesore; organe kolegjiale që janë rektorati, dekanati, këshilli etikës.

UWB ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 75, datë 19.04.2024 për një periudhë 6 vjeçare.

Aktualisht WBU është organizuar në 3 fakultete:

- Fakulteti i Mjekësisë Dentare
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
- Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në WBU që ofron programin e studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. FSHMT përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" ka katër departamente dhe një qendër kërkimore.

- Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
- Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri
- Departamenti i Mjekësisë
- Departamenti i Kirurgjisë
- Qendra kërkimore për studimin e sëmundjeve të rralla

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri.

Referuar tabelave 1 dhe 2 të RVB, në vitin akademik 2024 – 2025, njësia bazë përbëhet nga 13 anëtarë PAE (shënuar 12 në RVB) dhe përfshin në mësimdhënie dhe 14 anëtarë PAK. Kualifikimi i personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie është:

PAE	PAK
Tituj/Grada	Tituj/Grada
(0) Prof.	(0) Prof.
(0) Prof. Asc.	(1) Prof. Asc.
(5) Dr.	(2) Dr.
(8) Msc.	(11) Msc.

	Lidhur me treguesit e moshës, pjesa më e madhe të stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie i përkasin grup moshës 25-55 vjeç. <i>GVJ konstaton se përmbushet kriteri ligjor sipas të cilit 70% e ngarkesës mësimore duhet të mbulohej nga PAE.</i> <i>Nga analiza e tabelave mbi shpërndarjen e ngarkesës mësimore të programit rezulton së llogaritur në ECTS, PAE mbulojnë 79% të tyre (142 kundrejt 180).</i> <i>(Evidencat 1.1 Statuti i WBU, 1.3 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri, 1.6 Struktura organizative e FSHMT, Tabelat 2, 4, 6, 8 të RVB)</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	FSHMT dhe Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri kanë angazhuar në këtë program studimi dhe staf ndihmës akademik (asistentë mësimorë, laborantë etj.) që asistojnë studentët në realizimin e punëve laboratorike dhe praktikave në mjediset e institucionit. Numri i tyre nuk është pasqyruar në tabelat e RVB. Në funksion të programit të studimit janë dhe personeli administrativ i institucionit. Personeli i sekretarisë, NJSBC, strukturat e kurrikulave karrierës, të bibliotekës asistojnë studentët për të gjitha problematikat e procesit mësimor dhe i orientojnë për realizimin me sukses të programit. Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës akademik dhe administrativ dhe konstatoi se ky staf i përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione pune. <i>(Evidenca 2.6 Lista e personelit asistent lektor, ndihmës akademik/administrative, Tabelat 1 dhe 2 të RVB, takimet në institucion)</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në	FSHMT dhe Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga statuti dhe rregullorja themelore e institucionit kanë caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit Bachelor në "Teknik Laboratori". Koordinator i programit të studimit është personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri. Ai është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të praktikave profesionale në përputhje me objektivat e programit.

Tafelme

përputhje me objektivat e tij.	Në këtë program studimi studentët udhëzohen dhe mbështeten gjatë gjithë periudhës akademike dhe nga këshilltari akademik i caktuar nga stafi PAE. <i>(Evidencat 1.1 Statuti i WBU, 1.2 Rregullore themelore e WBU, 2.12 Vendimi mbi koordinatorin akademik të programit të studimit, 5.18 Praktika e informimit të studentëve nga këshilltari akademik i programit)</i>			
Konkluzione	UBU, FSHMT dhe Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri që ofrojnë programin e studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" përmbushin kërkesat ligjore dhe standartet e cilësisë për ofrimin e tij. Staf i akademik përbëhet nga një numër optimal pedagogësh PAE dhe PAK, me moshë relativisht të re. PAE mbulojnë mbi 70% të ngarkesës mësimore. Në funksion të programit të studimit institucioni ka angazhuar dhe personel ndihmës akademik dhe personelin administrativ. Në përmbushje të kërkesave ligjore departamenti ka caktuar koordinatorin përgjegjës për programin e studimit që veç të tjerash siguron lidhjen dhe shpërndarjen harmonike të studentëve në institucionet e kryerjes së praktikës. Institucioni ka angazhuar personel akademik me funksionin këshilltar akademik për mbështetjen e studentëve gjatë gjithë periudhës së realizimit të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	FSHMT dhe Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri në WBU që ofrojnë programin e studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" disponojnë gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Informacionet menaxhohen përmes një sistemi intranet të brendshëm në të cilën ka akses i gjithë personeli. Në dosjen e programit që GVJ ka në dispozicion kemi gjetur informacionin për institucionin dhe për strukturën e programit të studimit, informacion për strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, kuadrin e përgjithshëm formues

	të programit, të dhënat për personelin akademik për realizimin e programit, planin mësimor, të dhëna për infrastrukturën në dispozicion të programit, kriteret e pranimi, rregulloren e programit, syllabuset e lëndëve dhe modelin e diplomës. Me fillimin e vitit akademik programi i studimit dhe syllabuset ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi. Të dhëna mbi të programet e studimit gjenden dhe në faqen web të WBU. Në takimin me stafin dhe drejtuesit e institucionit u informuam për përfshirjen aktive të stafit në përgatitjen e RVB dhe hartimin e dokumentacionit bazë dhe mbështetës për procesin e akreditimit. <i>(Dosja e programit të studimit, takimet në institucion)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” është i organizuar në lëndë /module dhe praktikë profesionale në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në planin mësimor detajohet tipi i veprimtarisë formuese në auditor për secilën lëndë (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktika mësimore). Për secilën lëndë jepet informacion i detajuar për kreditet, totalin e orëve dhe ndarjen e tyre në orë në auditor/orë studimi individual. Jepet gjithashtu informacion për ndarjen e orëve në auditor në leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, projekte dhe praktika. Në planin mësimor dhe në syllabuse pasqyrohen dhe kreditet sipas sistemit amerikan. GVJ gjykon se raportet e veprimtarive formuese në auditor janë të arsyetuara sipas tipologjisë së lëndës. <i>(Evidencat 2.2 Kurrikula e programit të studimit, Syllabuset, Tabelat 9 dhe 10 të RVB)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Procedurat e pranimi të studentëve në programin e studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” bazohen në rregulloren themelore të WBU dhe rregulloret e tjera institucionale dhe të programit të studimit. Institucioni aplikon kriteret specifike të pranimi që vendosen me VKM dhe rregulloren e WBU. FSHMT propozon kriteret dhe kuotat e pranimi, kuotat e transferimit etj. mbështetur në kapacitetet pritëse dhe akademike të cilat miratohen nga senati akademik dhe dërgohen në QSHA. Informacioni publikohet në faqen zyrtare on line të WBU dhe në portalin U-Albania. Procesi i pranimi menaxhohet nga QSHA dhe RASH. Institucioni nxjerr njoftime

	për pranimin ku përshkruhet procedura e aplikimit, testimit, shpalljes së fituesve dhe regjistrimit. Institucioni ka një rregullore për njohjen dhe transferimin e studimeve përcaktohet mënyra e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. GVJ u njoh dhe me një praktikë transferimi në programin e studimit Bachelor në “Teknik Laboratori”. Në takimet me sekretarinë mësimore dhe studentët, GVJ konstatoi se institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë dhe të përditësuar për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. <i>(Evidencat 1.1 Statuti i WBU, 1.2 Rregullorja themelore e WBU, 2 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Teknik Laboratori, 5.12 Rregullore për njohjen dhe transferimin e studimeve, 5.13 Vendim i komisionit ad-hok për një rast transferimi, Faqja Web, Takimet në institucion)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë dhe për praktikën profesionale. Syllabuset janë formatuar në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Syllabuset janë të firmosura nga titullari i lëndës. <i>Bien në sy fakti që disa nga titullarët e lëndëve nuk janë të kategorisë Profesor (kërkesë e ligjit të arsimit të lartë). Shumica janë me gradë Dr..</i> <i>GVJ rekomandon rishikimin e titullarëve të lëndëve dhe përshtatjen e kategorisë së tyre sipas kërkesave ligjore.</i> Në syllabuse gjendet i detajuar informacioni për tipologjinë e lëndës, kreditet, shpërndarjen e orëve në auditor dhe jashtë tij, vitin dhe semestrin në të cilin zhvillohet lënda. Syllabusi jep informacion për lëndën, objektivat dhe rezultatet e pritshme. Temat, literatura referuese dhe format e mësimdhënies janë detajuar sipas javëve. Çdo syllabus ka informacion për frekuentimin dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Në syllabuse është specifikuar literatura bazë dhe literatura e rekomanduar. <i>(Evidencat 2.2 Kurrikula e programit të studimit, Syllabuset, Tabelat 9 dhe 10 të RVB)</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të	GVJ konstaton se programet e studimit në WBU janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Përmirësimi dhe përditësimi i programeve realizohet pas analizave vjetore dhe në funksion të vërejtjeve dhe problematikave të konstatuara.

vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Vlerësimi i programit bëhet përmes një sërë instrumentash cilësie si pyetsorët e përgatitur nga JSBC për studentët dhe të diplomuarit. NJSB ka krijuar mundësi për të tërhequr vlerësime dhe sugjerime edhe nga punëdhënësit e studentëve të diplomuar. Programi dhe syllabuset e përditësuara miratohen dhe arkivohen në department çdo fillim viti. Synohet përmirësim i programit në përmbajtje, literaturë e veçanërisht në implementim të metodologjive të reja mësimdhënëse. Programi Bachelor në “Teknik Laboratori” është një program i ri dhe ka pësuar pak ndryshime. GVJ u njoh me një syllabus të përmirësuar dhe procedurën e ndjekur. <i>(Evidencat 2.8 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.9 Model syllabusi i përmirësuar)</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit European të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit. Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e profesionit. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës. Programi i studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë dhe për praktikën profesionale. GVJ rekomandon rishikimin e titullarëve të lëndëve dhe përshtatjen e kategorisë së tyre sipas kërkesave ligjore (të jenë të kategorisë Prof. dhe Prof.Asc.). Pranimi, regjistrimi i studentëve dhe financimi në programet e studimit të WBU bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kapacitetet pritëse dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi përcaktohen me vendim senati.</i> <i>Institucioni deklaron se Programi është i kodifikuar dhe krijon mundësi për mobilitet, ndërkombëtarizim dhe ndjekje të mëtejshme të studimeve të ciklit të dytë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat e tregut lokal të punës si dhe krijon premisa për ekuivalentim të programit në tregun rajonal e më gjerë si dhe për kualifikim në programe të niveleve më të larta. Në planin mësimor vërehet një strukturim logjik dhe i përshtatshëm. Studenti merr në fillim njohuri bazë dhe formuese të profesionit të cilat i ballafaqon në seminarët, laboratorët dhe seancat praktike të vitit të parë. Në dy vitet në vijim, kurrikula ofron përgatitje më të thellë profesionale në fushat e veçanta të mjekësisë laboratorike, në organizim, automatizim, kontrollin e cilësisë etj. Këto njohuri konkretizohen në praktikat të cilat zenë një numër më të madhe ECTS. Në këtë program studenti merr njohuri dhe për testimet pranë vendit të kujdesit në urgjencë (testet POCT), aplikimin dhe interpretimin e tyre. Profesioni i teknikut të laboratorit e ve specialistin në kontakt direkt me pacientin por dhe me kolegët. Laboratori funksionon në bazë të një hierarkie profesionale e menaxheriale. Programi i jep njohuri studentit dhe për komunikimin etik, aspekte psikologjike e tjerë duke e aftësuar për punë në grup dhe për një shërbim etik ndaj pacientit. Elementët e shkrimit akademik, statistikës etj. krijojnë premisa që studenti të vijojë studime të mëtejshme në programe të ciklit të dytë e të tretë dhe të punojë aktivisht në grupe shkencore. <i>(Evidencat 2.2 Kurrikula e programit të studimit, Syllabuset)</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Siç u theksua dhe në Kriterin 1, programi ka një shpërndarje të llogjikshme të lëndëve në vite dhe semestra si dhe vlerësim në kredite sipas rëndësisë së syllabusit në arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës në orë mësimore /ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën studimit Bachelor në “Teknik Laboratori”. Studentët marrin një formim të gjerë për teknikat laboratorike bazë dhe ato më të zhvilloara të gjenetikës dhe biologjisë molekulare, aftësohen për realizimin e tesimeve në laboratorët biokimikë, imunologjikë, hematologjikë,

	mikrobiologjikë të anatomisë patologjike dhe në qendra kërkimore ku përdoren teknika të avancuara të biologjisë molekulare. Programi i përgatit studentët me elementë të etikës, sociologjisë dhe psikologjisë për të kultivuar tek specialistët e ardhshëm nocionet e komunikimit me pacientin. Njohuritë në automatizim, biostatistikë etj. i përgatisin studentët për një treg pune që përdor çdo ditë e më shumë elementë të inteligjencës artificiale si dhe ofron një bazë të mirë për studentët që duan të thellojnë njohuritë në nivelin Master Shkencor apo duan të përfshihen në realizimin e projekteve shkencore. <i>(Evidencat 2. Rregullorja e programit të studimit, 2.2 Kurrikula e programit të studimit, Syllabuset)</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" është strukturuar bazuar në modelet dhe praktikat më të mira të institucioneve partnere të arsimit të lartë. Struktura e programit, emërtimi, raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e profesionit dhe me programet europiane e më gjerë. WBU ka lidhur marrëveshje dhe ka bashkëpunime bilaterale apo në kuadër të projekteve të mobilitetit (Erasmus +) me institucione akademike ndërkombëtare. Këto bashkëpunime shërbejnë si një impuls i mirë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e vazhdueshëm strukturor të programit. Duke synuar ndërkombëtarizimin programi është strukturuar dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit European të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe sipas sistemit amerikan të krediteve. Programi ofrohet në dy gjuhë, shqip dhe anglisht duke u bërë tërheqës për studentët shqiptarë por dhe për studentët e huaj nga rajoni e më gjerë. <i>(Evidencat 2. Rregullorja e programit të studimit, 2.2 Kurrikula e programit të studimit, Syllabuset)</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Strukturimi i programit, unifikimi i termave të programit me programet europiane i bën studentët konkurrues në tregun e punës publik e privat, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Organizimi i programit është në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe përmirëson ndjeshëm mundësinë për arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitet dhe punësim. Edukimi Praktik Kurrikular i Integruar (EPIC) është një program unik i Arsimit në Universitetin Western Balkans që u ofron studentëve mundësinë e një kurrikule të integruar në një

	sistem arsimimi dyfish, në auditor dhe pranë operatorëve laboratorikë me të cilët WBU ka lidhur marrëveshjen EPIC. Mësimi përmes punës është një mundësi e mirë për njohjen e tregut të punës dhe orientimin e shpejtë në kërkimin e pozicionit të punës. Në takimet me studentët dhe Zyrën e këshillimit të karrierës u informuam për Zyrën e këshillimit të karrierës luan një rol aktiv pasi koordinon dërgimin e informacionit tek studentët dhe i ndihmon këta të fundit në aplikimet e tyre duke i paisur dhe me rekomandime. Megjithatë nga ky program studimi nuk ka ende të diplomuar ndaj nuk mund të kemi statistika për punësimin pës përfundimit të studimeve. Institucioni inkurajon studentët me rezultate të larta të përfshihen në procesin akademik si asistentë për vitet më poshtë. <i>(Evidencat 2. Rregullorja e programit të studimit, 2.2 Kurrikula e programit të studimit, 1.12 Lista e marrëveshjeve për EPIC, 1.13 Manualët e praktikave EPIC, takimi me studentët)</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	WBU është një institucion i ri me ambicie për të qenë një zë i rëndësishëm i arsimit të lartë në Shqipëri dhe me synime të qarta për përfshirje në zhvillimet akademike, shkencore, teknologjike të vendit dhe për ndërkombëtarizim. WBU ka ndërtuar, megjithatë një mekanizëm për pasqyrimin e kërkesave dhe nevojave për rishikimin e syllabuseve mbështetur në kriteret ligjore. Përmirësimi dhe përditësimi i syllabuseve reflekton kërkesat që dalin nga aplikimi instrumentave të cilësisë të aplikuar në nivel institucional si pyetsorët e studentëve për lëndën dhe pedagogët, analiza e kurrikulës përmes pyetsorëve të studentëve në prag diplomimi, analiza e kurrikulës me alumni (të paktën 3 vjet) dhe përfaqësues të tregut të punës ku punësohen studentët. Në vlerësimin e syllabusit dhe kurrikulës merren në konsideratë natyrisht sugjerimet e titullarit të lëndës dhe vlerësimet e tij mbështetur në eksperiencë dhe praktikën aplikative të programit. Të gjitha problematikat dhe sugjerimet bëhen pjesë e analizës vjetore të departamentit. Ndryshimet e programit miratohen nga Fakulteti dhe Senati akademik. <i>(Evidencat 2.8 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.9 Model syllabusi i përmirësuar)</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit	Programi është konceptuar dhe organizuar me njohuri teorike që rrjedhin nga shkencat bazë të biologjisë, kimisë, mjekësisë

garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	dhe me lëndë karakterizuese me profil të qartë profesional të cilat trajtohen në aspektin aplikativ duke krijuar një bazë formuese për t'u aftësuar në dy dimensionet e profesionit të teknikut të laboratorit, aplikimin me saktësi të procedurave/metodikave dhe interpretimin mjekësor. Bazuar në objektivat formues të dokumentuar në rregulloren e programit të studimit, kurrikula e programit Bachelor në "Teknik Laboratori" ofron edukim multidisiplinar duke aftësuar studentin për të punuar në çdo laborator bashkëkohor në fushat specifike të Biokimisë, Mikrobiologjisë, Patologjisë, Diagnozës molekulare, Immunologjisë, Hematologjisë, Histologjisë. <i>(Evidencat 2. Rregullorja e programit të studimit, 2.2 Kurrikula e programit të studimit)</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit është strukturuar në përputhje me kërkesat e ligjore. Programi i pajis studentët me një bazë të mirë njohurish teoriko-praktike në fushën e diagnostikës laboratorike. Përmes formimit të gjithanshëm programi synon të krijojë mundësi për punësimin e studentëve sipas kërkesave të tregut të punës. WBU ka bërë një vlerësim të thelluar të tregut të punës për të përshtatur programin me pritshmëritë dhe kërkesat e sektorit në nivel kombëtar e më gjerë. Në studimin e tregut të punës janë analizuar raportet e publikuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Statistikave në Republikën e Shqipërisë, institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me popullsinë, arsimin, shëndetësinë, systemin laboratorik, ofrimin e programit nga universitete të tjera. Në analizën e tregut janë marrë në konsideratë dhe informacionet zyrtare për largimin e të diplomuarve në profesionet mjekësore drejt Gjermanisë. Aplikimi i programit EPIC demonstroi komunikimin e ngushtë të WBU me institucionet e kryerjes së praktikës profesionale edhe për punësimin e studentëve. <i>(Evidencat 2. Rregullorja e programit të studimit, 2.2 Kurrikula e programit të studimit, 2.11 Studimi i tregut të punës)</i>
Konkluzione	<i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese dhe nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve. Strukturimi i programit, unifikimi i termave të programit me programet europiane i bën studentët konkurrues</i>

	<i>në tregun e punës publik e privat, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Organizimi i programit është në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe përmirëson ndjeshëm mundësinë për arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitet dhe punësim.</i> <i>Programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" mbështetet në një analizë të tregut të punës dhe synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat e tregut lokal të punës si dhe krijon premisa për ekuivalentim të programit në tregun rajonal e më gjerë si dhe për kualifikim në programe të niveleve më të larta. Në program ka një harmonizim të mirë të lëndëve të formimit bazë e karakterizues me praktikën profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" është ndërtuar bazuar në një analizë të detajuar të tregut të punës. Në hartimin e programit Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazherisë pjesë e FSHMT është konsultuar dhe ka marrë në konsideratë propozimet e institucioneve partnere dhe aktorëve të tjerë të tregut të punës. Partnerët kryesorë me ndikim në strukturimin e aplikimin e programit janë grupi i Spitaleve Amerikane dhe Hygeia. Programi është i ri (tre vite akademike) dhe ka patur modifikime fare të vogla (shih standardi II.3 kriteri 5). Institucioni ka parashikuar mekanizmat për tërheqjen e opinionëve, vërejtjeve, sugjerimeve, rekomandimeve nga aktorë të rëndësishëm përdorues të programit (pedagogët, studentët, të diplomuarit, përfaqësuesit e institucioneve që kanë punësuar të diplomuarit etj.) analizimin e tyre në mbledhjet vjetore të Departamentit dhe konceptimin e propozimit për përmirësim të përmbajtjes. <i>(Evidencat 2.8 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.9 Model syllabusi i përmirësuar, 2.11 Studimi i tregut të punës)</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al


Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Në parim WBU nxit dhe përfshin në diskutime studentët të cilët janë të përfaqësuar në senatin akademik dhe NJSBC. Studentët kanë gjithashtu organizimin e tyre në formën e Këshillit studentor. Në statut dhe rregulloren themelore të WBU theksohet se Dekanati i Studentëve është struktura përgjegjëse për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve dhe të diplomuarve në WBU. Programi i studimit është ende në fillimet e tij dhe nuk ka ende një brez të diplomuarish. Institucioni i ka paraprirë bashkëpunimit dhe për tërheqjen e mendim/propozimeve nga Studentët e diplomuar (Alumni) përmes krijimit të paketës së instrumentave të cilësisë që menaxhohen nga NJSBC (shih kriterin 1 të këtij standardi). Në takimin me studentët u informuam se ata kanë përfaqësuesit e tyre në organet e përmendura më sipër, shprehen lirshëm për problematikat dhe kanë plotësuar pyetsorët e NJSBC-së sipas grafikut të përcaktuar në rregullore. <i>(Evidencat 1.1 Statuti i WBU, 1.2 Rregullorja themelore e WBU, 2.8 Paketa e instrumentave të cilësisë, Takimi me studentët)</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Në RVB dhe dokumentacionin shoqërues evidentohet se institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhëra profesionale dhe institucione publike dhe private si dhe institucione homologe jashtë Shqipërisë në fushën e mjekësisë. Rrjeti i gjerë i bashkëpunitorëve kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e përditësimin e programit të studimit. Risi e programit të studimit është edukimi praktik kurrikular i integruar (EPIC) një program unik i Arsimit në Universitetin Western Balkans që u ofron studentëve mundësinë e një kurrikule të integruar në një sistem arsimimi dyfish, në auditor dhe pranë operatorëve laboratorikë me të cilët WBU ka lidhur marrëveshjen EPIC. <i>(Evidencat 1.12 Lista e marrëveshjeve për EPIC, 1.13 Manuallet e praktikave EPIC)</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" është ndërtuar bazuar në një analizë të detajuar të tregut të punës. Në hartimin e tij Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazherisë pjesë e FSHMT është konsultuar dhe ka marrë në konsideratë propozimet e institucioneve partnere dhe aktorëve të tjerë të tregut të punës. Në parim</i>

	<i>WBU nxit dhe përfshin në diskutime studentët të cilët janë të përfaqësuar në senatin akademik dhe NJSBC. Studentët kanë gjithashtu organizimin e tyre në formën e Këshillit studentor. Institucioni ka parashikuar mekanizmat për tërheqjen e opinioneve, vërejtjeve, sugjerimeve, rekomandimeve nga aktorë të rëndësishëm përdorues të programit (pedagogët, studentët, të diplomuarit, përfaqësuesit e institucioneve që kanë punësuar të diplomuarit etj.) analizimin e tyre në mbledhjet vjetore të Departamentit dhe konceptimin e propozimit për përmirësim të përmbajtjes. Rrjeti i gjerë i bashkëpunëtorëve kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e përditësimit të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1					
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.					
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në Rregulloren themelore të WBU, në rregulloret e programit të studimit dhe në Syllabuse e planin mësimor janë evidentuar format e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve që përdoren në programin e studimit Bachelor në “Teknik Laboratori”. Ato përfshijnë leksionet, seminarët, punët e laboratorit dhe detyrat e kursit, projektet, praktikat profesionale punimet e diplomës. Institucioni inkurajon gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve në konferenca, trajnime dhe workshop. Programi i studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” përfshin orë teorike dhe orë praktike (në laborator apo në institucionet e kryerjes së praktikës profesionale), detyra kursi, përgatitje të diplomës etj. të paraqitura në tabelën e mëposhtme të shpërndara sipas tipologjive të mësimdhënies. Në tabelë nuk figuron tema e diplomës pasi puna në auditor për përgatitjen e saj është përfshirë në rubrikën e seminarëve.				
	Bsc “Teknik Laboratori”	Viti I	Viti II	Viti III	Në total
	Në auditor				2010 (44.7%)
	- Leksione	360	345	315	1020
	- Seminare	150	120	210	480
	- Laboratore	120	60	105	285
	- Praktika	30	150	45	225
	Punë e pavarur e studentit				2490 (55.3%)
	Gjithsej				4500
	<i>(Evidencat 2.2 Kurrikula e programit të studimit, Syllabuset e lëndëve, Tabelat 10 – 14 të RVB)</i>				
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma,	WBU ka investuar në infrastrukturën teknologjike të sallave të leksioneve/seminareve, në infrastrukturën laboratorike dhe furnizimin me kite-reagentë në funksion të realizimit të qëllimit dhe objektivave të programeve të studimit që ofron. GJV inspektoi ambientet dhe vlerësoi kushtet e mësimdhënies				



mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	dhe të kryerjes së praktikave të pavarura apo nën mbikqyrje nga studentët. WBU ka investuar në teknologjinë e informacionit (smart WBU) duke vënë në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve platformat on line, bibliotekën on line dhe duke trajnuar stafin për përdorimin sa më të mirë në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në takimet në institucion me personelin akademik dhe me studentët GVJ u informua se personeli akademik ofron për studentët mënyra e metoda alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies në përputhje me nevojat e tyre. Gjatë mësimdhënies përdoren metoda të tilla si prezantime në ppt., video, përdorimi i tabelave Smart Board, biseda interaktive me studentët, demonstrimi i procedurave praktike laboratorike dhe aplikim nga studenti nën mbikqyrje, ushtrime me raste klinike etj. Staf i akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimin teorik, laboratorëve mësimore apo praktikave profesionale ku synohet pjesëmarrje aktive në procedura praktike. Praktikën në laboratorët bashkëpunëtorë mundësojnë aplikimin jashtë klasave mësimore, në mjedisin real të profesionit të teknikave të mësuara, në teknologji të ndryshme si një metodë alternative e mësimdhënies /mësimnxënies. <i>Në takimin me stafin akademik GVJ konstatoi se pedagogu ka liri akademike në zhvillimin e orës së leksionit; stimulohet mësimi interaktiv që kombinon shpjegimin me pyetjet për subjektin e shpjeguar apo ushtrimet në lidhje me të.</i> <i>(Evidencat takimet dhe vizita në ambientet e institucionit, tabelat 16 – 17 të RVB)</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Institucioni kujdeset për trajnimin periodik të stafit për metodat e reja të mësimdhënies si dhe monitoron realizimin e procesit mësimor. Trajnimi dhe kualifikimi i personelit akademik dhe ndihmës akademik ka në fokus rritjen e kapaciteteve në mësimdhënie. Trajnimet janë organizuar duke vlerësuar nevojat e personelit akademik, performancën e personelit akademik (përmes paketës së instrumentave të cilësisë) dhe janë pasqyruar në Paketën e trajnimeve. Ato janë realizuar on line apo në auditore nga studiues akademikë shqiptarë apo të huaj me eksperiencë në punën me student. Anëtarët e personelit akademik në WBU janë trajnuar gjithashtu për të përdorur Smartboard-et e instaluar në auditore. WBU zbaton politika të qartë për promovimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik dhe ndihmës akademik.

	Kualifikimi shkencor dhe trajnimet ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e kompetencave didaktike. <i>(Evidencat 3.2 Pëketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien, 3.3 Pyetsor për zhvillimin profesional të personelit akademik dhe administrative, Tabelat 19 – 29 të RVB)</i>																											
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në përgjithësi ka përgatitje profesionale, ekspertizë dhe eksperiencë mjekësore apo pedagogjike në lëndët që zhvillon. Nga shqyrtimi i dokumentacionit si CV e stafit akademik, Planit mësimor, Tabelat 4, 6.1, 6.2 të RVB, GVJ konstatoi se: • <i>Ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizën dhe formimin e tyre profesional. P.sh. seminarët e fiziologjisë zhvillohen nga pedagog i diplomuar në Msc. Infermieri, seminarët e mikrobiologjisë dhe biokimisë zhvillohen nga teknikë laborator (nuk kanë njohuri të plota dhe kompetencë në diagnozë mjekësore). Hematologjia zhvillohet nga biolog apo kardiolog, siguria e shëndetit në punë zhvillohet nga fizikant që është kompetent vetëm për disa aspekte të sigurisë në punë.</i> • <i>Ka pedagogë që japin më shumë se tre lëndë. Megjithatë ngarkesa mësimore e tyre nuk është mbi normën e parashikuar nga legjislacionit në fuqi, diversiteti i tematikave jashtë profilit të diplomimit ul cilësinë e mësimdhënies.</i> • <i>Disa nga titullarët e lëndëve nuk janë të kategorisë Profesor (kërkesë e ligjit të arsimit të lartë). Shumica janë me gradë Dr.</i> • <i>GVJ rekomandon përshtatjen e ngarkesës sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin 29 të MASR, datë 10/09/2018.</i> Sipas tabelës 2 të RVB personeli akademik i njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit për tre vite akademike paraqitet si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2024-2025</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2022-2023</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Asc.</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>3</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>5</td><td>2</td><td>3</td><td>2</td><td>4</td><td>1</td></tr></table>	Tituj/ grada	2024-2025		2023-2024		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Asc.	-	1	-	3	-	-	Dr./PhD.	5	2	3	2	4	1
Tituj/ grada	2024-2025		2023-2024		2022-2023																							
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																						
Prof.Asc.	-	1	-	3	-	-																						
Dr./PhD.	5	2	3	2	4	1																						

	Msc.	5+3*	8+3*	2+3*	6	1+3*	-
	Totali	13	14	8	11	8	1
	Shënim: Shenja * tregon që pedagogu ka specializim pasuniversitar						
	<i>Nga të dhënat e mësipërme dhe vlerësimi i të dhënave të tabelës 8 të RVB konstatohet se programi i studimit realizohet nga staf relativisht i ri, ndaj dhe numri i personelit të kategorisë Prof dhe Prof. Asc. është i ulur.</i> Në takimin me stafin konstatuam motivim dhe përkushtim, ambicie për kualifikim të mëtejshëm në fushat e ekspertizës përkatëse. Në takimin me studentët konstatuam se ata janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies, me komunikimin dhe ndërveprimin e pedagogëve në orët e mësimi si dhe me materialet didaktike që pedagogët përgatisin për procesin mësimor. Studentët referuan në takim se stafi ka ndërtuar mardhënie të respektit të ndërsjelltë duke iu krijuar hapësirë e nevojshme për shfaqjen e ideve të tyre kritike, për diskutime. Studentët ndihen të mbështetur dhe konstatohet një frymë pozitive hierarkie dhe bashkëpunimi. (Evidencat Tabelat e RVB, 34-CV e personelit akademik, takimet dhe vizita në institucion)						
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Njësia përgjegjëse e programit të studimit, Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri, pjesë e FSHMT ka në fokus përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies. Në funksion të përmirësimit institucioni realizon trajnime për aspekte kurrikulare dhe metodologjike për stafin akademik (standardi III.1, kriteri 3). Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vlerësimit, pjesë e paketës së instrumentave të cilësisë të pregatitur nga NJSBC. Pyetësorët vihen në dispozicion të studentit në fond të çdo semestri para provimit përfundimtar të lëndës, në fund të vitit akademik apo para diplomimit. Të dhënat e përftuara bëhen pjesë e vlerësimit të performancës së pedagogut. Të dhënat e përpunuara nga NJSBC iu vihen në dispozicion organeve drejtuese për të ndërmarrë inisiativa apo procedura në funksion të përmirësimit të punës.						

	Në funksion të përmirësimit institucioni realizon trajnime për aspekte kurrikulare dhe metodologjike për stafin akademik (standardi III.1, kriteri 3). Vlerësimi i pedagogëve përfshin dhe instrumenta të tjerë si plotësimi i formularëve të vlerësimit të personelit akademik nga kolegët, vetë vlerësimit si dhe vlerësimi i performancës vjetore shprehur në analizën vjetore të departamentit për çdo pedagog. <i>(Evidencat 2.10 Paketa e instrumentave të cilësisë, 3.6 Raport i vlerësimit nga studentët për personelin akademik, 3.4 Plani i trajnimeve për stafin akademik, 5.21 Raporti vjetor i Departamentit, 6.11 Formular për vlerësimin e personelit akademik nga kolegët, 6.4 Formular i vetëvlerësimit)</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Në WBU funksionon Komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë institucionale dhe programeve të studimit që bashkërendon punën me NJSBC për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e kërkimit shkencor. Institucioni ka organizuar NJSBC e cila koordinon dhe bashkëvepron me njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. NJSBC kryen vlerësime periodike për performancën akademike, cilësinë e mësimdhënies duke përdorur paketën e instrumentave të cilësisë që ka krijuar. Analiza e të dhënave publikohet në formë raportesh prej të cilave NJSBC nxjerr dhe rekomandime. Për të përmbushur rekomandimet, institucioni përmes strukturave organizative të tij organizon trajnimin dhe pjesëmarrjen e stafit akademik në projekte zhvillimin në të cilat veç aftësisht shkencor fitohet dhe eksperiencë në mësimdhënie. Për promovimin e aktivitetit shkencor të pedagogëve institucioni organizon aktivitete e konferenca me bashkëpunimin e partnerëve kombëtarë e ndërkombëtarë. Personeli është trajnuar dhe mbështetet vazhdimisht për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies. Institucioni vlerëson arritjet e stafit akademik dhe i prezanton në analizat e departamentit dhe fakultetit. NJSBC ka krijuar protokollet për përgatitjen e pyetsorëve në nivel institucional. Në takimet me stafin akademik u konstatua fryma pozitive e institucionit në raport me bashkëveprimin hierarkik dhe horizontal në nivel njësie qëndrore dhe njësie bazë. <i>(Evidencat 1.1 Statuti i WBU, 3.7-3.8 Vendimi për ngritjen dhe rregullorja e Komisionit të, përhershëm për garantimin e</i>

	standarde dhe cilësisë institucionale dhe programeve të studimit, 3.9-3.10 Vendimi për ngritjen dhe rregullorja për funksionimin e NJSBC, 3.11 Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara pas rekomandimeve të NJSBC, 3.12 Plani i aktiviteteve të NJSBC, 3.13 Lista dhe raporti i trajnimeve 2022-2023, 2023-2024, 3.14-3.15 Trajnimet on line dhe udhëzuesi i sistemit të informacionit SMART WBU, Takimet në institucion)		
Konkluzione	Institucioni garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. WBU ka investuar në infrastrukturën teknologjike bashkëkohore të sallave të leksioneve/seminareve, në infrastrukturën laboratorike të përshtatshme dhe të plotë si dhe në furnizimin me kite-reagentë në funksion të realizimit të qëllimit dhe objektivave të programit të studimit. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgjithësisht përgatitje profesionale, ekspertizën dhe eksperiencë mjekësore apo pedagogjike në lëndët që zhvillon. Megjithatë GVJ konstatoi se ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizën dhe formimin e tyre profesional dhe pedagogë që japin më shumë se tre lëndë. GVJ rekomandon përshtatjen e ngarkesës sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin 29 të MASR, datë 10/09/2018. NJSBC kryen vlerësime periodike për performancën akademike, cilësinë e mësimdhënies duke përdorur paketën e instrumentave të cilësisë që ka krijuar. Në funksion të përmirësimit institucioni realizon trajnime për aspekte kurrikulare dhe metodologjike për stafin akademik. Institucioni mbështet dhe promovon aktivitetin shkencor të stafit akademik.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloret e përgjithshme të institucionit përcaktohen në mënyrë specifike të gjitha rregullat dhe modalitetet e testimit të njohurive, kriteret e kalimit në vitin pasardhës, mënyrat e përmirësimit, notat kaluese, sezonet e provimeve etj. Në syllabuset e lëndëve pasqyrohen format e kontrollit të njohurive. Syllabuset iu vihen në dispozicion studentëve që në javën e parë të zhvillimit të mësimi dhe bëhen publike. Studentët informohen rregullisht për ndryshimet. <i>(Evidencat 1.2 Rregullorja themelore e WBU, 2 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Teknik Laboratori", 3.1 Rregullore për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë)</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët informohen në javën e parë të vitit akademik mbi kuadrin rregullator të programit mësimor. Ato informohen në orët e para të mësimi nga titullari i lëndës mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Metodologjia e vlerësimit përshkruhet dhe në syllabuset e lëndëve dhe rregulloret e funksionimit të Universitetit, Fakultetit, dhe programit të studimit. Vlerësimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Komponentë të vlerësimit janë pjesëmarrja aktive në seminare, detyrat e kursit, testimi i ndërmjetëm dhe testimi përfundimtar. Të dhënat për mënyrën e vlerësimit janë pasqyruar në tabelën 15 të RVB. Pas informimit të studentëve, pedagogu i lëndës publikon sistemin e vlerësimit, në platformën SMART WBU ku studenti, përmes aksesit individual konsulton në kohë reale rezultatet e tij. <i>(Evidencat 3.16 Prezantimet e javës së orientimit, 1.2 Rregullorja themelore e WBU, 2.7 Syllabuset e lëndëve, Tabelat e RVB)</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe	Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit, punët e laboratorit, niveli i aktivizimit në seminare/laboratore, provimi i ndërmjetëm dhe provimi përfundimtar. GJVJ konstaton se në shumicën e lëndëve 50% të

mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	pikëve studenti i siguron nga puna gjatë vitit dhe 50% nga provimi përfundimtar. Në lëndën e praktikës Vlerësimi gjatë vitit zë 70% të pikëve duke synuar aftësimin praktik të studentëve. . Vlerësimi i vazhdueshëm i jep mundësi studentit të demonstrojë më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Në rregulloret institucionale përcaktohen format e provimit me shkrim, me gojë ose të kombinuara. Në takimin me stafin akademik u informuam se provimet zhvillohen kryesisht me shkrim dhe të sekretuara. Tezat e provimit hartohen nga pedagogu i lëndës dhe firmoset nga drejtuesi i njësishë bazë para zhvillimit të provimit. Pedagogu i lëndës mund ta kryejë provimin dhe me gojë, në formë projekti apo detyre kursi. Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve brënda 10 ditëve pas zhvillimit të provimit. Procedura e provimeve kryhet në bazë të rregullores së programit të studimit. <i>(Evidencat 1.2 Rregullorja themelore e WBU, 2 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Teknik Laboratori", 3.17 Udhëzim për procesin e sekretimit të provimeve gjatë vitit akademik)</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Në takimin me titullarët e institucionit, me stafin akademik dhe GVB u informuam se përmirësimi i metodave të mësimdhënies është në fokus të punës së përditshme të Departamentit të Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazherisë. Në këtë proces një rol të rëndësishëm luajnë studentët të cilët përfshihen përmes përdorimit të paketës së instrumentave të cilësisë të përgatitur nga NJSBC. Konkretisht, studentët në fund të çdo semestri plotësojnë 2 pyetsorët për vlerësimin e pedagogut dhe të lëndës. Pyetsori aktivizohet në sistemin on line para provimit përfundimtar të lëndës. Sistemi siguron anonimitetin e studentit. Studentëve iu kërkohet të shprehen për përpikmëtinë e pedagogëve dhe menaxhimin e kohës gjatë orës së mësimi, përgatitjen dhe zotërimin e njohurive, materialin dhe metodat e mësimdhënies, nderveprimin me studentët dhe performancën e tyre. Rezultatet përpunohen nga NJSBC dhe analizohen nga Departamenti në funksion të përmirësimit të merformancës akademike të programit të studimit. <i>(Evidencat 2.10 Paketa e instrumentave të cilësisë, 6.1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët, 3.18 Model Proçesverbal i vlerësimit të një lënde, Takimet në institucion)</i>

Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Institucioni ofron mundësi për përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike duke patur në qendër studentin. Studentët inkurajohen për punë të pavarur në ambientet e laboratorëve dhe në institucionet e kryerjes së praktikës për të krijuar sensin e autonomisë dhe forcuar besimin në aftësitë dhe gjykimin profesional. Gjatë procesit mësimor dhe praktikës profesionale studentët asistohen nga pedagogët e tyre për zgjidhjen e problematikave dhe përfitimin e njohurive. Mësimi përmes punës është një risi dhe mundësi e mirë për njohjen e tregut të punës dhe orientimin e shpejtë në kërkimin e pozicionit të punës. Edukimi Praktik Kurrikular i Integruar (EPIC) është një program unik i Arsimit në Universitetin Western Balkans që u ofron studentëve mundësinë e një kurrikule të integruar në një sistem arsimimi dyfish, në auditor dhe pranë operatorëve laboratorikë me të cilët WBU ka lidhur marrëveshjen EPIC. Institucioni mbështet dhe inkurajon bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjellë pedagog-student. Marrëdhëniet e ndërsjellta pedagog-student apo pedagog-pedagog ndërtohen bazuar në kodin e Etikës. <i>(Evidencat 2.7 Syllabuset e lëndëve, 1.13 Manualët e praktikave EPIC, 3.20 Kodi i etikës, takimet në institucion)</i>
Konkluzione	Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Studentët informohen në fillim të vitit akademik nga titullari i lëndës mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Informacioni i detajuar gjendet në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. që realizohet me anë të provime, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare, praktika, provimi përfundimtar. Provimi zhvillohet me shkrim me gojë ose i kombinuar. Përmirësimi i vazhdueshëm i metodave të mësimdhënies mbetet prioritet i Departamentit ku zhvillohet ky program studimi. WBU përfshin dhe studentët në këtë proces. Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit profesional teorik të studentëve.

	Në këtë program studimi aplikohet mësimi përmes punës, një risi dhe mundësi e mirë për njohjen e tregut të punës dhe orientimin e shpejtë në kërkimin e pozicionit të punës.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Në rregulloren e programit të studimit, në tabelat e RVB dhe në pjesën më të madhe të syllabuseve përcaktohet se: • 20% e pikëve të notës fitohen nga ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive dhe projektet • 30% e pikëve të notës fitohen nga provimi i ndërmjetëm • 50% e pikëve të notës fitohen nga provimi përfundimtar Në varësi të tipologjisë së syllabusit, komponentët e vlerësimit mund të ndryshojnë. P.sh. Praktika profesionale ka skemën e mëposhtme të vlerësimit: • 50% e pikëve të notës fitohen nga punët laboratorike • 20% e pikëve të notës fitohen nga provimi i ndërmjetëm • 30% e pikëve të notës fitohen nga provimi përfundimtar Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, dhe në bazë të rregulloreve, numri i pikëve i referohet notës përkatëse. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari lëndës/pedagogu. <i>(Evidenca 2 Rregullorja e programit të studimit, 2.7 Syllabuset)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në programin e studimit bachelor në “Teknik Laboratori” në WBU, forma kryesore e përdorur për testimin e njohurive është provimi me shkrim. Pedagogët përdorin dhe forma të tjera testimi si Google form. Testimi bëhet i sekretuar përmes një sistemi barcode që menaxhohet nga platforma SMART WBU. Qëllimi i përdorimit të barcode nuk është vetëm sekretimi por dhe identifikimi unik i çdo flete provimi që lejon dhe përpunim më të shpejtë e më të saktë të rezultateve. Përgjegjës për

Adresa: “Ruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	proçesin e sekretimit dhe gjenerimit të barcode-eve janë Koordinatorët e Departamenteve. Pas korrigjimit të provimeve, pedagogu i lëndës hedh pikët në sistem sipas barcod-eve. Pas hedhjes së pikëve, sistemi proçedon automatikisht me çkodimin e të dhënave për secilin student. Sistemi i mësipërm ul mundësitë e abuzimit, subjektivitetit dhe shton transparencën e vlerësimit. <i>(Evidenca 2 Rregullorja e programit të studimit, 3.15 Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART WBU, 3.17 Udhëzim për proçesin e sekretimit të provimeve gjatë vitit akademik)</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar nga një komisioni i përbërë nga dy pedagogë. Teza e provimit hartohet nga pedagogu i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Proçesverbali i provimit gjithashtu, firmoset nga titullari i lëndës dhe përgjegjësi i departamentit. Në rregulloren themelore të WBU dhe në rregulloret e programeve të studimit përcaktphet qartë sistemi i vlerësimit me notë dhe me shkronjë në shtatë nivele (referuar sistemit shqiptar). • Nota 4: 0 – 49 pikë, shkronja F • Nota 5: 50 – 54 pikë, Shkronja D • Nota 6: 55 – 64 pikë, Shkronja C • Nota 7: 65 – 74 pikë, Shkronja B- • Nota 6: 75 – 84 pikë, Shkronja B • Nota 6: 85 – 89 pikë, Shkronja A- • Nota 6: 90 – 100 pikë, Shkronja A Risi e WBU është dhe vlerësimi sipas sistemit amerikan (nga 0 deri në 4). Në rregulloret e institucionit përcaktohen qartë dhe modalitetet e provimit dhe shënimit për studentët që për arsye të caktuara nuk kanë përmbushur detyrimet dhe iu jepet mundësi e dytë, studentët e transferuar, ata që nuk kanë përmbushur detyrimet e frekuentimit etj. GVJ u njoh në sekretarinë mësimore me formatin e fletës së provimit dhe proçedurën. <i>(Evidencat 1.2 Rregullorja themelore e WBU, 3.1 Rregullore për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e</i>

	integruara të ciklit të dytë, 3.18 Model procesverbal vlerësimi i një lënde, vizita në institucion)
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i vazhdueshëm i njohurive është transparent. Studenti informohet në vijimësi nga pedagogu i lëndës për rezultatin e akumuluar nga detyrat, projektet, punët e laboratorit si dhe nga provimi i ndërmjetëm dhe këshillohen për përmirësim. Në funksion të përmirësimit në të ardhmen, titullarët e lëndës organizojnë konsultime në grup apo individuale dhe japin detyra shtesë. Ecuria e studentëve monitorohet dhe nga këshilltari akademik i cili mundëson këshillim të personalizuar për problematikat dhe vështirësitë që parashtrijnë studentët në përgatitjen dhe aftësimin profesional. <i>(Evidencat 1.2 Rregullorja themelore e WBU, 3.1 Rregullore për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë)</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Institucioni ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime. Në institucion funksionon Kodi i Etikës që plagjiaturën e konsideron sjellje të ndaluar. Në rregulloret e institucionit dhe në kodin e etikës pasqyrohen penalitete për rastet e kopjimit apo plagjiaturës. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë apo komunikimi midis studentëve. Për të shmangur abuzimet, provimi i ndërmjetëm dhe provimi përfundimtar monitorohen nga pedagogu i lëndës dhe një vëzhgues (pedagog ose staf administrative). Programet Erasmus dhe QA_SURE kanë ndihmuar që institucioni të investojë në sistemet elektronike antiplagjiaturë. <i>(Evidencat 1.2 Rregullorja themelore e WBU, 3.1 Rregullore për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë, 3.19 Projekti QA-SURE, 3.20 Kodi i Etikës)</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në rregulloren themelore të WBU përcaktohet se rezultatet e provimit pasqyrohen nga pedagogu i lëndës në procesverbalin e provimit. Procesverbalet dorëzohen në sekretari brenda 2 javësh nga data e zhvillimit të provimit. Procesverbali firmoset nga pedagogu i lëndës dhe koordinatori i departamentit. Procesverbali nuk duhet të ketë korrigjime. Institucioni ka një procedurë të gjurmueshme për raste kur kërkohet ndryshimi i rezultatit për arsye të gabimit teknik gjatë përpilimit të rezultatit.

	Rezultatet e konfirmuara hidhen në regjistrin e notave dhe regjistrin elektronik. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GJVJ u njoh me procesverbale të lëndëve si dhe me regjistrin e notave. GJVJ u informua se nuk ka regjistër për lëndët e profilit në gjuhën shqipe. <i>(Evidencat 1.2 Rregullorja themelore e WBU, vizita në sekretarinë mësimore)</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit. Këto rregullore i japin të drejtë studentit të njihet me vlerësimin, të ankimohej për vlerësimin, të mund të përmirësojë notën përmes riprovimit. Studentët u shprehën në takim me WBU se e njohin këtë aspekt të rregullores dhe procedurën përkatëse. Nuk u referua ndonjë rast konkret prej tyre. Nëse studenti nuk është dakord me rezultatin e provimit ai paraqet ankesë me shkrim në sekretarinë mësimore jo më vonë se një javë nga publikimi i rezultateve. Ankimi shqyrtohet nga komisioni i krijuar me vendim të këshillit të departamentit ku nuk merr pjesë pedagogu i lëndës. Vendimi i komisionit i bëhet i ditur studentit brenda 15 ditësh pas ankimimit. Procedura dokumentohet dhe arkivohet për të siguruar transparencë dhe gjurmueshmëri. <i>(Evidencat 1.2 Rregullorja themelore e WBU, vizita në sekretarinë mësimore, takimi me studentët)</i>
Konkluzione	<i>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në rregulloret e institucionit dhe syllabuset e lëndëve/moduleve. Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. WBU përdor sistem barcode për sekretimi e fletëve dhe si element sigurie në hedhjen dhe publikimin e rezultateve të provimit. Studentët njihen me rezultatin e provimeve në mënyrë konfidenciale përmes llogarisë së tyre personale në sistemin SMART WBU. Studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të</i>

47

E. Durrës



	<i>studimit. Vlerësimi bazohet në meritë. WBU ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e studimit “Teknik Laboratori”. WBU ka dizenuar një program bashkëkohor, multidisiplinar që krijon premisat për një pregatitje dhe formim të integruar të studentit në teknika laboratorike të avancuara të fushave të biokimisë, hematologjisë, mikrobiologjisë, anatomisë patologjike si dhe në element të biologjisë molekulare, imunologjisë që përdoren në të gjithë laboratorët e mësipërm. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. Në funksion të programit të studimit institucioni kë ndërtuar një rrjet laboratorësh të paisur në mënyrë bashkëkohore ku studenti realizon aplikimin praktik dhe formon shprehitë e para profesionale. Praktika profesionale dhe mësimi në kuadër të projektit EPIC e zhvendos studentin në mjedisin real të profesionit duke synuar konsolidimin e dijeve të marra në auditor. <i>(Evidenca 2 Rregullorja e programit të studimit, 2.2 Kurrikula e programit të studimit, 2.1 Syllabusi i praktikës, 2.7 Syllabuset e lëndëve)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” mësimor krahas lëndëve të formimit bazë dhe formimit karakterizues të profesionit përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshëm si gjuha e huaj, informatikë, biostatistikë, ekonomi shëndeti dhe menaxhim laborator, etikë dhe legjislacion. Përmes këtyre lëndëve synohet zhvillimi i aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit. WBU ka një laborator të kompletuar të informatikës në funksion të pregatitjes së studentëve, laboratorët e lëndëve janë

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	të paisura me mjete të teknologjisë së lartë (tavolina digitale anatome, mikroskopi elektronik, aparaturat diagnostike laboratorike). Sallat e leksioneve janë të paisura me mejte të avancuara teknologjike. Studenti menaxhon aktivitetin e tij, rezultatet, kërkesatpërmes platformës online. Biblioteka ka fondin fizik por vez në dispozicion të studentit dhe bibliotekën on line. Të gjithë elementët e mësipërm kontribuojnë në zhvillimin e aftësive të studentit në fushën e teknologjisë, komunikimit dhe ndërveprimit. <i>(Evidenca 2.2 Kurrikula e programit të studimit, 2.7 Syllabuset e lëndëve, takimet në institucion)</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në përfundim të lëndës, në orën e fundit të mësimit pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme, si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Pedagogu ndalet në veçanti në temat që janë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të tyre. Në fund të praktikës profesionale pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale të fituara nga studentët. <i>(Evidenca 2.2 Kurrikula e programit të studimit, 2.7 Syllabuset e lëndëve, takimet në institucion)</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të	Programi Bachelor në "Teknik Laboratori" ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin e misionit dhe për t'u përballur me kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu gjatë programit të studimit studentët fitojnë njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe ndërveprimit/legjislacionit për pranimin e përgjegjësi në fusha të menaxhimit apo drejtimit. Programi i studimit është specifik dhe bazohet në punën individuale të studentit dhe mësimi në auditor. Gjatë realizimit të procesit mësimor stafi akademik mbështet punën në grup të studentëve, diskutimet e rasteve klinike në seminare, praktika mësimore dhe veçanërisht ato profesionale. Marrëveshjet e bashkëpunimit me laboratorë dhe marrëveshjet në kuadër të programit EPIC kanë zgjeruar mundësitë e përfitimit të njohurive profesionale, të punësimit si dhe të mobilitetit për studentët e këtij programi studimi.

përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme duke ju vënë në dispozicion laboratorët, bibliotekën e Universitetit apo sallat e kompjuteravë dhe asistencën nga stafi akademik. Studentët inkurajohen të përfshihen në kryerjen e referimeve në aktivitetet që organizon departamenti, temave të kursit, projekte të ndryshme. Referuar tabelës 22 të RVB nga studentët janë të përfshirë në punimet shkencore individuale të pedagogëve (3 studentë), në projektet shkencore të Departamentit (5 studentë) dhe të Fakultetit (10 studentë). Studentët referuan në takim pjesmarrjen e tyre në projektin e Dr. A. D. për studimin e sindromit metabolik dhe insulinorezistencës. <i>(Evidencat 2.2 Kurrikula e programit të studimit, 2.1 Syllabusi i praktikës, 1.13 Manualet e praktikave EPIC, 1.8/1.11 Marrëveshjet e bashkëpunimit me laboratorët e spitalit Amerikan dhe Cambridge, 3.22 Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore, takimet dhe vizita në institucion)</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore WBU organizon leksione të hapura nga anëtarët e personelit akademik. Në këto aktivitete ftohet stafi akademik për ndarje eksperience dhe studentët. FSHMT realizon në mënyrë periodike orë të hapura dhe seminare me ekspertë të fushave të ndryshme të shkencës, shqiptarë apo të huaj. Në këto aktivitete përfshihen dhe studentët. Institucioni disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve. Institucioni mbështet pedagogët në karrierën shkencore duke alokuar fonde për projektet e kërkimit shkencor, duke sponsorizuar pjesmarrjen e tyre në aktivitete shkencore e publikime dhe duke krijuar facilitete për realizimin e projekteve kërkimore në laboratorët e institucionit ose në laboratorët partnerë. Në takimet në institucion u informuam se po punohet për organizimin e një konference studentore e cila synojnë të zhvillohet në mënyrë periodike. <i>(Evidencat 3.12 Plani i aktiviteteve të NJSBC, 3.26 Lista e aktiviteteve të organizuara nga FSHMT gjatë viteve akademike 2022 – 2023, 2023 – 2024)</i>

Konkluzione	Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e studimit "Teknik Laboratori". WBU ka dizenuar një program bashkëkohor, multidisiplinar që krijon premisat për një përgatitje dhe formim të integruar të studentit në teknika laboratorike të avancuara të fushave të biokimisë, hematologjisë, mikrobiologjisë, anatomisë patologjike si dhe në element të biologjisë molekulare, imunologjisë që përdoren në të gjithë laboratorët e mësipërm. Programi i studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" mësimor krahas lëndëve të formimit bazë dhe formimit karakterizues të profesionit përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshëm si gjuha e huaj, informatikë, biostatistikë, ekonomi shëndeti dhe menaxhim laborator, etikë dhe legjislacion. Përmes këtyre lëndëve synohet zhvillimi i aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit. Studentët inkurajohen të përfshihen në kryerjen e referimeve në aktivitetet që organizon departamenti, temave të kursit, projekte të ndryshme. Në funksion të një përgatitje të gjithanshme profesionale dhe të formimit të mendimit kritik, institucioni organizon në mënyrë periodike leksione të hapura apo konferenca shkencore me pjesmarrjen e mjekëve të shquar vendas apo të huaj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	WBU ka publikuar në faqen e internetit të gjithë kurrikulat e programeve të studimit, përfshirë dhe informacionin mbi detyrimet përmbyllëse. Statuti, rregullorja themelore e WBU, rregullorja e programit të studimit dhe kurrikula e programit të studimit përcaktojnë se cikli i studimeve Bachelor në "Teknik Laboratori" mbyllet me Diplomë ose provim përfundimtar që kategorizohet si veprimtari e tipit E dhe ka 6 ECTS. Studentit në fund të studimeve i lind e drejta të pajiset me diplomë Bachelor në "Teknik Laboratori" pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur diplomë ose provimin final. Me vendim të senatit, detyrimet përmbyllëse në programin e studimit Bachelor në

	“Teknik Laboratori” do të kryhen përmes provimit përfundimtar. WBU ka përcaktuar në rregulloren e programeve të studimit pragun e notës mesatare (nota 7) që i jep të drejtën studentit të ciklit të parë të diplomohet. GVJ diskutoi me stafin për këtë detaj të rregullores jo të zakonshëm në universitetet shqiptare. WBU përmes këtij kufiri synon cilësinë e studentëve në dalje të programit dhe shtimin e mundësive për punësim, mobilitet dhe vijimin në programe të ciklit të dytë e më tej. Nuk janë hasur probleme në aplikimin e këtij kriteri. <i>(Evidencat 1.1 Statuti i WBU, 1.2 Rregullorja themelore e WBU, 2 Rrregullore e programit të studimit, 2.2 Kurrikula e programit të studimit, Takimet në institucion)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Fokusi i programit Bachelor në “Teknik Laboratori” është përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit. Bazuar në këtë qëllim provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit në provimin përfundimtar ose në përgatitjen e një teme diplome. Në këtë vit akademik diplomohet brezi i parë në këtë program studimi. Forma e vlerësimit do të jetë përmes provimit përfundimtar. Pedagogët i orientojnë studentët dhe iu japin informacion lidhur me temat apo materialet që duhet të konsultohen për provimin final si dhe literaturën që duhet të shfrytëzojnë. Koordinator i programit dhe këshilltari akademik luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces. Udhëzuesi për strukturën e hartimit të tezës dhe programin e provimit përfundimtar i vihet në dispozicion studentëve të cilët kanë dhe një udhëheqës akademik që asiston përgatitjen e tyre. <i>(Evidencat 1.2 Rregullorja themelore e WBU, 2 Rrregullore e programit të studimit, 2.2 Kurrikula e programit të studimit, 2.3 Vendim senati mbi provimin përfundimtar, 3.27 Manuali për punimin e diplomës)</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha	Studenti mbron diplomën pasi ka plotësuar të gjitha kreditet e programit të studimit dhe ka siguruar notën mesatare të paktën 7. Testimi bazohet në njohuritë e marra gjatë programit të studimit. Provimi përfundimtar i formimit mund të zhvillohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Mënyra e organizimit të

lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	provimit të përgjithshëm përfundimtar përcaktohet në rregulloren e programit të studimit. Këtë vit akademik procedura implementohet për herë të parë ndaj GVJ nuk ka evidenca të procesit të kryer (Fletë provimi). <i>(Evidencat 2 Rrregullore e programit të studimit)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave. Përpara përfundimit të studimeve departamenti përcakton lëndët e formimit të përgjithshëm, karakterizues dhe me zgjedhje që do përfshihen në provim dhe titullari i lëndës përcakton temat që do përfshihen në provim të cilat do përbëjnë fondin e pyetjeve të provimit. Këto ju vihen në dispozicion studentëve në ëformën e Manualit për punimin e diplomës. Studenti informohet për fondin e pyetjeve dhe mënyrën e vlerësimit të paktën dy muaj përpara përfundimit të semestrit. Udhëheqësit e diplomës ose bashkëudhëheqësit mund të jenë edhe përfaqësues të institucioneve partnere apo përfaqësues të biznesit, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në rregulloret e diplomave. <i>(Evidencat 3.27 Manuali për punimin e diplomës)</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	WBU dhe FSHMT kanë krijuar një infrastrukturë të përshtatshme laboratorike ku studentët mund të kryejnë matjet dhe testimet specifike për punimet e diplomës. Pjesën praktike të temave të diplomës studentët mund ta kryejnë dhe në institucionet/ Laboratorët partnere. Siç u përmend më sipër në këtë raport, viti akademik 2024 – 2025 është viti i parë i diplomimit në këtë program studimi. Me vendim senati, diplomimi do të kryhet me provim përfundimtar. <i>(Evidencat Tabelat 16 të RVB, 1.8/1.11 Marrëveshjet e bashkëpunimit me laboratorët e spitalit Amerikan dhe Cambridge vizita në institucion)</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi përfundimtar i provimit përfundimtar apo temës bëhet me notë. Teza korrigjohet nga komisioni. Proçes verbali përfundimtar firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe dorëzohet në sekretari. Vlerësimi me notë bëhet sipas sistemit shqiptar, Sistemit European të transferimit të Krediteve (ECTS) dhe sistemit amerikan. Aplikimi i këtyre sistemeve shton

	mundësitë e mobilitetit, të njohjes së diplomës dhe punësimit brenda dhe jashtë Shqipërisë. <i>(Evidencat 2 Rregullore e programit të studimit)</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës në përputhje me dispozitat e Rregullores Themelore të WBU. Diploma është sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori. Diploma lëshohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Studenti paiset dhe me suplementin e diplomës. <i>(Evidencat 1.2 Rregullore themelore e WBU, 3.28 Model diplome)</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar. Institucioni mund të japë informacion për studentët nëse kërkohet. Dokumentacioni administrohet, përpunohet dhe arshivohet në Sekretarinë mësimore e cila funksionon bazuar në rregulloret e administrimit të WBU dhe të zyrës. Në sekretaritë mësimore të fakultetit gjëndet regjistri themeltar i studentëve, regjistri i vlerësimeve të marra nga studentët gjatë viteve të studimit në programin e studimit. Dokumentacioni ruhet në përputhje me rregulloren e institucionit për "Mbrotjtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale". Dok GVJ verifikoi dokumentacionet e depozituara në sekretarinë mësimore dhe i gjeti në përputhje me kërkesat e ligjit. Dokumentat e munguar (regjistri themeltar për këtë program studimi) janë kërkuar dhe institucioni është në pritje të marrjes në dorëzim. Platforma SMART WBU dixhitalizon informacionin përpunimi i të cilit realizohet nga zyrat e sekretarisë mësimore dhe burimeve njerëzore. <i>(Evidencat 1.1 Statuti i WBU, 1.10 Rregullore mbi organizimin administrativ të WBU, 3.30 Rregullore e Zyrës së sekretarisë mësimore, 3.29 Rregullore për mbrotjtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, vizita në sekretarinë mësimore)</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Bachelor në "Teknik Laboratori" dhe e pajis atë me dokumentacionin</i>

	përkatës. Institucioni asiston studentët për përgatitjen e provimit përfundimtar dhe krijon kushte për realizimin e testimeve në kuadër të temës së diplomës. Provimi përfundimtar/teza e diplomës vlerësohet me notë, ECTS dhe kredite sipas sistemit amerikan duke lehtësuar punësimin dhe transferimin. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet që përcakton rregullorja themelore e WBU.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën	Në këtë fakultet aktivizohen një numër optimal personeli akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK), si dhe personel ndihmës akademik (PNA), specialistë të fushave që mbulon secili departament. Departamenti i Shkencave Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri që ofron programin e studimit angazhon në mësimdhënie personel akademik me kualifikim kryesisht të fushës së mjekësisë, biologjisë, kimisë, bioteknologjisë të shpërndarë në vite si më poshtë. Viti akademik 2024 – 2025 • PAE 13, të kategorive: 5 Dr., 8 Msc.(3 me specializim pasuniversitar SPA) • PAK 14, të kategorive: 1 Prof. Asc., 2 Dr., 11 Msc. (3 me SPA) Viti akademik 2023 – 2024

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

- PAE 8, të kategorive: 3 Dr., 5 Msc. (3 me SPA)
- PAK 11, të kategorive: 3 Prof. Asc., 2 Dr., 6 Msc.

Viti akademik 2022 – 2023

- PAE 8, të kategorive: 4 Dr., 4 Msc. (3 me SPA)
- PAK 1, të kategorive: 1 Dr.

GVJ konstaton se ka një përmirësim të kapaciteteve akademike në vijimësinë 3 vjeçare të programit të studimit. Në takim me drejtuesit e institucionit dhe stafin akademik u theksua mbështetja që institucioni i siguron stafit për kualifikim, punime shkencore për fitimin e titujve dhe gradave për të plotësuar në të ardhmen plotësisht kërkesat ligjore për stafin akademik.

Niveli i kualifikimit për stafin akademik që jep mësim në këtë program studimi Bachelor në “Teknik Laboratori” është si me poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	-	-	-	-	-	-
Prof. As. Dr	1	-	3	2	3	2
Dr.	11	1	11	2	12	3
MSc (asistentë)	5	4	6	6	11	1
Total	17	5	20	10	26	6

Evidenca: ANEKS - TEKNIK LABORATORI .pdf (tabela 6.1)

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit si CV e stafit akademik, Planit mësimor, Tabelat 4, 6.1, 6.2 të RVB, GVJ konstatoi se:

- *Ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizën dhe formimin e tyre profesionale. P.sh. seminarët e fiziologjisë zhvillohen nga pedagog i diplomuar në Msc. Infermieri, seminarët e mikrobiologjisë dhe biokimisë zhvillohen nga teknikë laborator (nuk kanë njohuri të plota dhe kompetencë në diagnozë mjekësore). Hematologjia zhvillohet nga biolog apo kardiolog, siguria e shëndetit në punë zhvillohet nga fizikant që është kompetent vetëm për disa aspekte të sigurisë në punë.*
- *Ka pedagogë që japin më shumë se tre lëndë. Megjithëse ngarkesa mësimore e tyre nuk është mbi normën e parashikuar nga legjislacionit në fuqi, diversiteti i tematikave jashtë profilit të diplomimit ul cilësinë e mësimdhënies.*

	Disa nga titullarët e lëndëve nuk janë të kategorisë Profesor (kërkesë e ligjit të arsimit të lartë). Shumica janë me gradë Dr.
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Është konsideruar e rëndësishme dhe parësore për WBU qëndrueshmëria e personelit akademik, duke i krijuar mundësi për oferta akademike të tij. Vërehet krijim i raporteve të drejta midis kategorive të personelit akademik, moshës dhe eksperiencës, duke mundësuar vazhdimësi, shkëmbim përvoja etj. Sipas Statutit të Universitetit, Kodit të Punës, Ligjit të Arsimit të Lartë, hartohet kontrata e punës, me kushtet e punës e të trajtimit, të parashikuara në kontratë. Dokumentacioni është i plotë dhe ruhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Institucioni krijon mundësi për lehtësime në pjesën financiare për trajtimet shëndetësore, falë bashkëpunimit me Spitalin Amerikan, për shërbimet e marra pranë këtij spitali, për tarifa të reduktuara për personelin e universitetit dhe familjarët e tyre. Gjithashtu, ndiqen me shumë korrektesë politikat për sigurimin e jetës dhe shëndetit të studentëve dhe stafit. <i>Evidenca 4.9. Lista e stafit të angazhuar në programin e studimit</i> <i>Evidenca 4.10. Kontrata e ruajtjes fizike</i> <i>Evidenca 4.7. Lista e stafit akademik sipas njësive bazë</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Personeli i WBU-së përbëhet nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Personeli mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si dhe me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Sipas Statutit të Universitetit dhe Rregullores mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit, kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e saj. Kriteret miratohen më pas nga Rektorati. Njoftimet për vendet e lira shpallen në web-site të institucionit. Në njoftim jepet informacioni lidhur me përshkrimin e vendit të punës, detyrat e përgjegjësitë dhe të dhënat mbi afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm. Procedura e konkurimit drejtohet nga një komision ad-hoc, i cili i paraqet Rektoratit (nëpërmjet Dekanit) propozimin për punësim. Punësimi i personit të konsideruar fitues miratohet nga Bordi i Administrimit dhe pajiset me kontratën e punës. Për nevojat të caktuara bëhet edhe punësim i stafit me kohë të pjesshme, me një procedurë të ngjashme.

	<i>Evidenca 4.13. Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit</i> <i>Evidenca 4.14. Linku për publikimin e vendeve të lira të punës</i> <i>Evidenca 4.15. Praktikat e punësimit në WBU</i> <i>Evidenca 4.8. Kontrata e punës së personelit akademik</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Universiteti WBU ka të punësuar edhe personel ndihmës-akademik, i cili ndahet në personel ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe ndihmës akademik me karakter administrativ. Personeli ndihmës-akademik me karakter akademik mbështet realizimin e veprimtarive akademike dhe të kërkimit shkencor. Personeli ndihmës-akademik merret në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi lidhur me nivelin e kualifikimit. <i>Evidenca 1.9. Rregullorja mbi organizimin akademik, Neni 32</i> <i>Evidenca 2.6. Lista e personelit asistent lector.</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit	Personeli i angazhuar përcaktohet në fillim të çdo viti akademik, sipas kriterëve ligjore në fuqi dhe sipas rregulloreve të brendshme të institucionit. Titullaret miratohen në Senatin Akademik dhe vijon procedura nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila menaxhon personelin, në përputhje me legjislacionin në fuqi duke organizuar dhe sistemin e informacionit të personelit. Kjo zyrë menaxhon, ruan dhe përditëson të dhënat e stafit të institucionit, të titujve të tyre, daljen në pension, të rekrutimit dhe ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ruan dosjet e personelit dhe i përditëson ato, harton dhe mban kontratën e punës dhe ndjek përfundimin e saj me personelin. <i>Evidenca 1.10. Rregullorja mbi organizimin administrative të Universitetit Wester Balkans, Neni 32.</i>

ndihmës dhe administrativ.	
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	WBU ka një sërë marrëveshjes dhe bashkëpunimesh me IAL të tjera, biznese dhe kompani, edhe në industri e sektorë të ndryshëm. Këto marrëveshje me IAL e kompani të ndryshme shërbejnë për realizimin e praktikave profesionale, por edhe si mundësi për studentët për kërkimet e tyre për punimin e diplomës. Institucioni vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm dhe të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike, sipas natyrës së programit të studimit. Praktikave profesionale, përgatitja e diplomës etj zhvillohen nën mbikëqyrjen e personave përgjegjës, pjesë e stafit akademik efektiv apo persona të tjerë që përmbushin kriteret sipas specifikave të temës së diplomës. Temat e diplomës, udhëheqësit dhe komisionet miratohen nga Dekanati. <i>Evidenca 1.1. Statuti I Universitetit Western Balkans, Neni 26, pikat p dhe q, Neni 52, pika e dhe n.</i>
Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Praktikat profesionale për këtë program zhvillohen në institucione të ndryshme dhe lidhja me Spitalin Amerikan dhe institucione të tjera bashkëpunetore përbën një pikë të fortë në këtë drejtim. Për praktikave veprohet sipas marrëveshjeve të përbashkëta me institucionet partnere, si me Shoqërinë American Hospital SH.A dhe International Hygea Hospital SH.A, Cambridge Clinical Laboratories, etj., ku kryhen praktikave profesionale, në kuadër të formimit të plotë teorik dhe praktik të studentëve. Ndjekja e praktikave profesionale bëhet nga personeli përgjegjës duke mbajtur dokumentacionin e duhur. Praktikat profesionale kryhen me grupe deri në 20 studentë, dhe vlerësohen me nota. Institucioni krijon mundësi për aplikimin në praktikë të njohurive nëpërmjet programit Education Practice - Integrated Curriculum (EPIC) (https://wbu.edu.al/sq/epic), projekt nga i cili mund të përfitojnë të gjithë studentët e WBU. <i>Evidenca 1.8. Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Shoqërinë American Hospital SH.A dhe shoqërinë International Hygea Hospital Sh.A.</i>

	Evidenca 1.13. Manualët e praktikave EPIC.			
Konkluzione	Konstatohet se IAL për këtë program studimi, përgjithësisht përmbush kërkesat e përcaktuara për angazhimin e personelit akademik sipas kualifikimit të duhur. Zyra e Burimeve Njerëzore, pjesë e strukturës organizative të IAL, ruan dhe arkivon të dhënat e dokumentuara në dosjet e personelit. Personeli mbikëqyr praktikat profesionale të studentëve në bashkëpunim me institucionet bashkëpunuese, ndihmon studentët në kryerjen e praktikës dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit lidhur me praktikën profesionale. Megjithatë GVJ konstatoi se ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizën dhe formimin e tyre profesional dhe pedagogë që japin më shumë se tre lëndë. GVJ rekomandon përshtatjen e ngarkesës sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin 29 të MASR, datë 10/09/2018.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	WBU siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, WBU është i organizuar si një kampus universitar i përbërë nga 3 godina, parkim dhe hapësira të tjera të lira. Godinat janë të standarteve bashkëkohore, me ashensor. Godinat përmbajnë 10 salla leksioni, 10 salla seminari, 1 sallë konference, 17 laboratore, 3 salla interneti, disa laboratorë të pajisur me aparaturë moderne, salla me kompjutera, si dhe bibliotekë e ambiente të tjera në shërbim të programit të studimit. Kjo infrastrukturë mundëson kryerjen më së miri të gjithë veprimtarive mësimore. Të gjitha këto mjedise mund të përdoren për zhvillimin e procesit mësimor nga studentë të programit të ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Teknik Laboratori. IAL parashikon mbështetje financiare për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e aseteve të tij, sipas buxhetit të parashikuar. Mjediset e institucionit janë të përshtatshme gjithashtu edhe për persona me aftësi të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	kufizuara. Të gjitha godinat plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin e IAL. Vendodhja e kampusit në autostradë, largësia mund të ndikojë në numrin e ulet të studentëve, ose në frekuentimin e mësimdhënies. Evidenca 4.18. Fragmenti i Hartës Kadastrale të WBU Evidenca 4.19. Planimetria e Kampusit Universitar
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gvj gjatë vizitave në IAL, konstatoi dhe vizituam nga afër të gjitha ambjentet e mësimdhënies të cilat ishin të pajisura me kompjutera, smart board, video projektorë dhe mjete elektronike të teknologjisë më të fundit të informacionit, që mundësojnë realizimin e procesit mësimor me standart të lartë, duke përdorur teknologji bashkëkohore të mësimdhënies. Laboratorët rezultuan që ishin të pajisura me mjetet e nevojshme për procesin mësimor. Ata plotësojnë standartet lidhur me sipërfaqen, ndricimin, ajrimin dhe kondicionimin. Studentët kanë mundësi të përdorin veshje të posacme dhe dollape për lehtësi në menaxhimin e pajisjeve në laborator. Evidenca 4.24. Lista e laboratorëve të WBU Evidenca 4.22. Model Inventar i zyrës së personelit akademik
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në WBU janë në funksion të procesit mësimor 27 laboratorë, studio e mjediset të tjera. Laboratorët përmbajnë aparatura, pajisje dhe mjete bashkëkohore të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, për aftësimin teorik e praktik të studentëve dhe për realizimin e objektivave të Prog. të Studimit. Ambientet laboratorike plotësojnë standartet bashkëkohore të nevojshme për procesin mësimor. Në shërbim të programit të ciklit të parë "Bachelor" në "Teknik Laboratori" janë 6 laboratorë: 1. Laboratori i Biokimisë Klinike 2. Laboratori i Mikrobiologjisë dhe Histologjisë 3. Laboratori i Kimisë 4. Laboratori i Fiziologjisë 5. Laboratori i Anatomisë 6. Laboratori i Biologjisë Molekulare Në laboratore, në shërbim të studentëve është personeli përkatës i specializuar Për zbatimin e rregullave të sigurisë

	laboratorët janë pajisur me Manualet e laboratorit, sipas specifikave të tyre. Evidenca 4.27. Marrëveshja për evadimin e mbetjeve laboratorike Evidenca 4.25. Inventar laboratorit Evidenca 4.26. Manualet e laboratorëve.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në ambientet e WBU konstatuam se ka tre laboratorë të teknologjisë së informacionit (Laboratori i Shkencave Kompjuterike dhe Inteligjencës Artificiale, Laboratori i Shkencave Kompjuterike dhe Sigurisë Kibernetike, dhe Laboratori i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë Software), të pajisur me kompjutera të avancuar, me programe profesionale specifike sipas programeve të studimit që IAL ofron. Nëpërmjet SMART-WBUrealizohet përdorimi i teknologjisë në lidhje me informatizimin e dokumentacionit. WBU ka ofruar për personelin dhe studentët shërbime interneti dhe laboratorë. Sallat janë të pajisura me Smart-boards, ambientet e bibliotekës janë të pajisur me kompjutera, personeli dhe studentët mund të shfrytëzojnë bibliotekën dhe një databazë digjitale. Risi e institucionit është krijimi i laboratorit të VR (Virtual Reality), i cili ndihmon të gjithë studentët të cilët realizojnë seanca të posaçme në funksion të procesit mësimor. Evidenca 4.24. Lista e laboratorëve të WBU Evidenca 3.15. Udhëzues I sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU Evidenca 4.30. Dokumenti i abonimit në JSTOR
Konkluzione	Universiteti Western Balkans ka në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë më të fundit dhe të nevojshme për një realizim sa më profesional të procesit mësimor dhe praktikave laboratorike. WBU dhe DSHMLI ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme si CCL, Spitalet Amerikan dhe Hygeia, Melior Med, etj. për të garantuar realizimin e praktikave mësimore dhe klinike të studentëve, me qëllim përfitimin e njohurive dhe kompetencave profesionale.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura gjendet në bibliotekën e WBU si në gjendje fizike dhe digjitale, falë anëtarësimeve që IAL ka bërë në JSTOR apo Research4Life. Literatura për PS përditësohet nga Departamentet çdo fillim viti akademik, duke përcjellë literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar në Fakultet, e më tej në organet e tjera vendimmarrëse. Në bibliotekën e WBU gjenden tekste mësimore të viteve të fundit dhe literaturë plotësuese e mjaftueshme në sasi dhe cilësi, me shumë tituj prestigjozë; burimet fizike janë mbi 30.000, si edhe 250000 tituj librash elektronikë. Biblioteka mundëson edhe 36 burime online, të cilat aksesohen nga web-faqja e bibliotekës https://library.wbu.edu.al/. Literatura e ofruar është kryesisht nga botime të pesë viteve të fundit dhe nga shtëpi botuese prestigjioze në nivel të lartë ndërkombëtar. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve nga WBU ofrohet në gjuhën e programit të studimit, anglisht dhe shqip. Për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Teknik Laboratori”, literatura bazë dhe ndihmëse ofrohet në gjuhën angleze dhe shqip. WBU Library https://library.wbu.edu.al/ është një asset i rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit mësimor, temat e diplomes, si dhe për njohuri të tjera shtesë. Evidenca 4.32. Lista e librave (Fondi i Bibliotekës) Evidenca 4.34. Rregullorja e Bibliotekës Evidenca 4.31. Akses në Research4Life
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazherisë është njësia përgjegjëse që shikon dhe përditëson nevojat që ka stafi akademik për pasurimin e literaturës. Zyra e Teknologjisë së Informacionit dhe Bibliotekës është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të titujve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	të ardhur në bibliotekë për studentët apo stafin. Fondi i bibliotekës pasurohet në mënyrë periodike, sipas kërkesave dhe nevojave të njësive. IAL ka mundësuar aksesin dhe përdorimin e teksteve dhe publikimeve nëpërmjet abonimeve në biblioteka online, sikurse JSTOR apo Research4Life. Funksionimi i bibliotekës bazohet në Rregulloren e bibliotekës. Biblioteka pasurohet vazhdimisht për t'u siguruar studentëve literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar, për programin e studimit, nga vetë Biblioteka ose me kërkesë të stafit akademik për lëndë të veçanta. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie çdo vit përditëson literaturën për lëndët që mbulon dhe i pasqyron ato në sylabusin e lëndës përkatëse. Evidenca 4.35. Praktika e kërkesës për pasurimin e fondit të bibliotekës Evidenca 4.32. Lista e librave (Fondi i Bibliotekës) Evidenca 4.30. Dokumenti i abonimit në JSTOR
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e WBU është një bibliotekë akademike; ajo përmban burime të printuara fizike të cilat gjenden fizikisht në bibliotekë, burime elektronike të cilat janë të përshtatshme për kurrikulën dhe fushën, të blera në versionin digjital, e-libra, e-revista, e-gazeta, etj.) dhe burime online (databaza, biblioteka dixhitale, revista elektronike, etj., të marra nga Universiteti nëpërmjet abonimit) (https://library.wbu.edu.al/sq/resources). Biblioteka e Universitetit është e bazuar në kurrikulën universitare. Burimet e bibliotekës mund të aksesohen nga Staf i akademik dhe administrativ dhe studentët, duke ndjekur rregullat specifike të bibliotekës, të përcaktuara në Rregulloren e Bibliotekës.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e	Biblioteka e WBU është e pajisur me një fond shumë të pasur fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit (https://library.wbu.edu.al/sq/resources), burimet fizike të bibliotekës janë mbi 30.000 tituj, dhe mbi 250,000 tituj librash elektronike, etj. Biblioteka mundëson 36 burime online, të cilat aksesohen nga web faqja e bibliotekës https://library.wbu.edu.al/.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascl.al

Web site: www.ascl.al

specifikës së programit të studimit.	
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Stfai akademik dhe studentët e të gjithë programeve të studimit në WBU mund të përdorin në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë të gjitha mundësitë që ofron biblioteka e institucionit, fizikë si dhe për burimet online. Burimet e pasura të bibliotekës mund të aksesohen nga Staf i akademik, administrativ dhe studentët, duke ndjekur rregullat specifike të bibliotekës. Mjediset dhe shërbimet e bibliotekës vihen në dispozicion të studentëve sipas orareve të miratuara dhe publikuara. Rregullat e bibliotekës janë vendosur në hyrje të saj dhe janë publikuar online në ueb-in e WBU https://library.wbu.edu.al/assets/images/Library-Rules.pdf.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e WBU është e pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, për të siguruar aksesin në koleksione dhe burime informacioni të nevojshme për studime dhe punë shkencore, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Ajo është e pajisur me të gjithë infrastrukturën teknike dhe teknologjike, për të mundësuar kushte optimale për personelin dhe studentët që duan të shfrytëzojnë atë. Hapësirat janë të mëdha e të mjaftueshme. <i>Evidenca 4.34. Regullorja e Bibliotekës</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e WBU është në dispozicion të studentëve në orare të përshtatshme, sipas nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Biblioteka ka në dispozicion mbi 100 vende. Për huazimin e fondit fizik, biblioteka është në dispozicion të studentëve dhe të personelit akademik gjatë orarit zyrtar të punës, ndërsa fondi digjital mund të aksesohet në çdo kohë nga web-i i WBU dhe llogaria personale e studentit / personelit akademik, duke u loguar në platformën "SMART-WBU" https://wbu.easy-web.cloud/. <i>Evidenca 4.34. Regullorja e Bibliotekës</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës	Biblioteka e WBU ndjek përditësimin e fondit të saj dhe informon në kohë reale mbi prurjet e reja (fondit fizik dhe të fondit online) personelin akademik, njësitë bazë dhe ato kryesore, përgjegjëse për programet e ndryshme të studimit.

dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka njofton personelin akademik dhe studentët për përditësimin e titujve të saj, apo anëtarësimet e reja që mund të bëhen online. Njësitë bazë dhe kryesore kanë një bashkëpunim të vazhduar me Bibliotekën, sidomos për sigurimin e titujve të nevojshëm për zhvillimin e lëndëve në programe të caktuara. Priorja është gjithmonë për të pasuruar fondin e bibliotekës me botime të viteve të fundit. Evidenca 4.37. Praktikë për informimin e personelit akademik për cilësinë e fondit fizik dhe fondit online të bibliotekës/ Raporti vjetor i bibliotekës së WBU 2022-2023			
Konkluzione	GVJ vlerëson se IAL plotëson kriterin dhe ka siguruar ofrimin e burimeve të nevojshme për mbështetje të procesit mësimor dhe kërkimor. Biblioteka është e pajisur me fonde të mjaftueshme, në gjuhën shqipe dhe angleze, si në format fizik dhe online, që plotësojnë kërkesat e programit të studimit dhe u ofrojnë studentëve mundësi për shfrytëzim. Raportohet rregullisht për cilësinë e fondit fizik dhe online të bibliotekës, duke përfshirë titujt kryesorë që janë në shërbim të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në	IAL ka një sistem të menaxhimit, të bazuar në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, nëpërmjet të cilit administrojnë gjithë informacionin që IAL ka lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre.

diplomim në programin e studimit.	Mënyra e menaxhimit të informacionit lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre, bëhet sipas përcaktimeve në Statutin dhe në Rregulloren e WBU. Nëpërmjet SMART-WBU realizohet përdorimi i teknologjisë mbi automatizimin e dokumentacionit; po kështu nëpërmjet platformës SMART-WBU, institucioni disponon digjitalizimin e dokumentacionit sipas njësive prodhuese. Mbledhja dhe përpunimi i statistikave realizohet nga zyrat administrative si Sekretaria Mësimore dhe Burimet Njerëzore. IAL disponon dhe ruan kopje fizike dhe në formë elektronike të dokumentacionit të studentit, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Zyra e Protokollit dhe Korrespondencës është përgjegjëse për arkivimin, administrimin, ruajtjen dhe përdorimin e dokumenteve të institucionit. Zyra mbledh, administron, ruan, evidenton dhe vë në shfrytëzim dokumentet e krijuara nga organet drejtuese dhe njësitë e institucionit. Zyra e Sekretarisë Mësimore është përgjegjëse për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti ose transkripti, lidhur me studentët. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave të studentëve nga IAL kryhet sipas parimit të konfidencialitetit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale të përcaktuara në Statutin e WBU dhe në Rregulloren për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. <i>Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Western Balkans, Neni 122</i> <i>Evidenca 1.2. Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 79</i> <i>Evidenca 2.10. Rregullorja mbi organizimin administrativ të WBU</i>
--	---

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmës-akademik, administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Zyra e Burimeve Njerëzore administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, etj, të angazhuar në realizimin e programit, në përputhje me nevojat e fakulteteve. Burimet Njerëzore ruajnë dhe përditësojnë çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në çdo program studimi. <i>Evidenca 2.10. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans, Neni 4.</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit siguron garanton akses të dedikuar dhe të sigurt në informacione dhe dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit, në përputhje me përshkrimin e dhënë dhe përgjegjësitë/rolin e secilit.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit në WBU përfshin platforma dhe module të integruara që mundësojnë komunikim interaktiv dhe shkëmbim efikas informacioni ndërmjet stafit akademik dhe studentëve. Çdo pedagogu dhe studentëve u është lënë një hapësirë e përshtatshme lidhur me rolin dhe pozicionin e tyre brenda institucionit. Kjo strukturë ndihmon në mbështetje të koordinuar të aktiviteteve akademike dhe administrative. Studentët përmes llogarisë së tyre mund të marrin shumë informacione rreth programit të studimit, si sylabuset e lëndëve, vlerësimi i vazhduar, prania gjatë orëve mësimore, apo për çështje të tjera që lidhen me sekretarinë mësimore dhe zyra të tjera. Personeli i IAL dhe studentët kanë të gjithë adresa zyrtare të komunikimit të brendshëm elektronik nëpërmjet platformës “SMART-WBU” https://wbu.easy-web.cloud/, https://smart.wbu.edu.al/ për komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor (personelin akademik dhe ndihmës-akademik, sylabuset e lëndëve, materialet mësimore, detyrat apo projektet, vlerësimin e vazhdueshëm, etj.)
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton	Sistemi i menaxhimit në WBU garanton monitorim në kohë reale të aktiviteteve akademike dhe administrative, duke

monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	mundësuar raportime individuale dhe furnizim me të dhëna të përditësuara për organet dhe autoritetet drejtuese. Ky sistem ofron transparencë dhe efikasitet në menaxhimin e informacionit, si dhe një reagim të shpejtë ndaj kërkesave dhe nevojave të institucioneve dhe strukturave të vendimarrjes.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Programet e studimit që ofrohen në WBU, programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, të gjitha informacionet publikohen në faqen e internetit në gjuhën shqipe https://wbu.edu.al/sq/program/laboratory-technician dhe në gjuhën angleze https://wbu.edu.al/en/program/laboratory-technician .			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se IAL përdor një sistem të avancuar për administrimin e informacionit mbi studentët dhe aktivitetin e tyre, duke garantuar monitorimin e aktiviteteve akademike dhe administrative në kohë reale, duke mundësuar menaxhim efikas dhe transparent. Të gjithë studentët, staf akademik dhe administrativ, komunikojnë nëpërmjet sistemit të tyre të brendshëm Smart-WBU, ku secili ka llogarinë e vet në sistem. Çdo e dhënë mbi lëndët, vlerësimet etj për ecurinë e studentëve paraqitet në kohë reale. Cdo informacion që lidhet me programet e studimit, stafin akademik, apo aktivitetet është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të WBU në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për	Raporti vjetor i veprimtarisë së institucionit, është dokumenti që përmbledh veprimtarinë vjetore akademike dhe veprimtarinë vjetore financiare. Ai është bazë për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të IAL. Dokumentet përfundimtar bazohet në raportet e veprimtarisë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	akademike të njësive kryesore si dhe njësive të tjera përbërëse të WBU. Dokumenti diskutohet dhe miratohet në mbledhjet e Rektoratit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Ai i dërgohet MAS dhe publikohet në faqen zyrtare të WBU. Nga IAL ndiqen me përpikmëri aktet ligjore e nënligjore në fuqi lidhur me raportimin financiar të kostove. Raportet financiare hartohen çdo vit, brenda afateve të përcaktuara, me pasqyra të hollësishme financiare, dhe janë pjesë e raportit vjetor të veprimtarisë së institucionit. Ato publikohen edhe në web-faqen e QKB dhe arkivohen çdo vit pranë drejtorisë përkatëse. Raporti pasqyron qartë grantet e huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të mbarëvajtjes institucionale. Të ardhurat e krijuara nga universiteti përdoren tërësisht prej tij dhe pjesa e papërdorur e tyre mbartet në vitin pasardhës. <i>Evidenca 4.38. Raporti Vjetor institucional për vitin akademik 2023-2024.</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Buxheti i WBU-së është një dokument i detajuar në organizim dhe përmbajtje. Ai bazohet në projektet e paraqitura gjatë hartimit të tij, në realizimin e pritshëm të buxhetit për vitin përkatës dhe përditësimet në strukturën organizative dhe numrin e punonjësve, programet e studimit, numrin e studentëve etj. Njësia që ka një kërkesë, plotëson formularin standard të “Kërkesë për Furnizim / Pajisje me Materiale” dhe ia paraqet atë Zyrës së Prokurimeve dhe Shërbimeve Administrative. Plani i financimit të WBU dhe njësive bazë përgjegjëse për njësitë kryesore, njësitë bazë ose për programin e studimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. Menaxhimi administrativ, financiar, ekonomik dhe i aseteve të institucionit janë përgjegjësi e Bordit të Administrimit, sipas Statutit të WBU, Rregullores së WBU dhe Rregullores së Bordit të Administrimit. Strukturat paraqesin një herë në vit kërkesat dhe projekt propozimet e tyre, të cilat janë pjesë e parashikimit financiar të buxhetit. Buxheti i propozuar diskutohet në Senat dhe në Bordin e Administrimit.

	Si IAL private, për blerjet nuk është i varur nga dispozitat ligjore shtetërore dhe është i lirë të përcaktojë nëse do të aplikohet tender ose jo. Evidenca 4.39. Buxheti vjetor i WBU për vitin 2023-2024 Evidenca 1.2. Rregullorja themelore e WBU, Neni 9
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	WBU ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe financiar dhe kryen auditim periodik të brendshëm, duke vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Përveç auditimit të brendshëm ka të parashikuar edhe auditimin e jashtëm, sipas legjislacionit në fuqi. Evidenca 4.41. Raporti i auditimit të brendshëm të WBU 2023
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Sipas Rregullores mbi organizimin administrative të WBU, administratori i fakulteti realizon administrimin financiar dhe administrativ të fakultetit, mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë financiare të fakultetit, plotëson kërkesat e dekanit, për përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare. Evidenca 1.10. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Bordi i Administrimit, garanton qëndrueshmërinë financiare dhe administrative të WBU dhe përmbushjen e misionit të tij. Ky bord përcakton edhe rregullat për shpërndarjen e të ardhurave të IAL, si edhe kontrollon përdorimin e burimeve të financimit. Bordi i Administrimit dhe strukturat e tjera përgjegjëse të WBU analizojnë periodikisht zbatimin e politikës financiare, nëpërmjet rishikimit të buxhetit dhe rialokimit të fondeve. Shpërndarja dhe menaxhimi i burimeve financiare monitorohen dhe llogariten në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në vend. Mënyra e përdorimit të fondeve për çdo vit akademik, përshkruhet në Raportin Vjetor Institucional, i publikuar në faqen zyrtare web. WBU ka Zyren e Financës, përgjegjëse për përgatitjen e plan programit buxhetor të IAL, për zbatimin e tij dhe për përdorimin e burimeve njerëzore, monetare apo materiale. Evidenca 1.2. Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Western Balkans, Neni 4,5

Konkluzione	Nga GVJ konstatohet se bordi i administrimit dhe strukturat e tjera përgjegjëse të WBU analizojnë në mënyrë periodike treguesit e monitorimit të zbatimit të politikës financiare, nëpërmjet rishikimit periodik të buxhetit dhe rialokimit të fondeve kur eshte e nevojshme. Shpërndarja dhe menaxhimi i burimeve financiare monitorohet dhe llogaritet në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në Shqipëri. Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe siguron qëndrueshmërinë financiare të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Si grup i vlersimit të jashtëm konstatuam që IAL bën pranimin e studentëve duke i kushtuar rëndësi ecurisë dhe suksesit të tyre gjithashtu dhe politikave, procedurave të përcaktuara në akte të brendëshme të institucionit. Pranimi në programet e ciklit të parë dhe të integruara ka si kusht për çdo kandidat që të ketë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. IAL vendos edhe kriteret shtesë pranimi për përzgjedhjen e studentëve për ciklin e parë dhe për programet e integruara, të cilat shpallen vit pas viti dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MAS. Kriteret bëhen publike nga njësia kryesore dhe QSHA-ja dhe miratohen nga Senati Akademik. WBU ka parashikuar rregullat dhe kërkesat për zhvillimin e provimeve. Studenti duhet të ketë mesataren e përgjithshme mbi 7 për diplomimin e tij. Sipas Rregullores Themelore, përcaktohen qartë kushtet për kalimin nga një vit në tjetrin. Studenti mund të hyjë në provimin e mbrojtjes së diplomës / ose provimin përfundimtar pasi ka shlyer të gjitha detyrimet. Studenti i cili ka plotësuar të gjitha detyrimet e një programi studimi, pajiset me diplomën përkatëse, e cila është një dokument zyrtar. Evidenca 1.2. Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans", Neni 54 Evidenca 1.2. Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans", Neni 89 Evidenca 3.28. Model diplome
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Studentët mund të regjistrohen në programet e studimit sipas LAL 80/2015 dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të MAS në WBU pasi të plotësojnë kriteret përkatëse të pranimit. Politikat dhe procedurat e aplikuara në WBU garantojnë barazinë për të gjithë studentët e programit të studimit. Studimet në WBU mund t'i ndjekin studentë shqiptarë dhe të huaj, studentë sipas marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, si dhe shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar një program studimi në arsimin e lartë. Për studentët e huaj WBU ka hartuar një procedurë të veçantë, ku janë përcaktuar kriteret specifike që duhet të plotësojnë për t'u pranuar si studentë në WBU. Aplikimi bëhet online në faqen web të WBU https://wbu.edu.al/en/international-admissions, ku gjendet informacion i detajuar për programet, tarifat e studimit, etj. Në programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Teknik Laboratori" vazhdojnë studimet 3 studentë të huaj. Universiteti pranon një numër të kufizuar të studentëve, bazuar në kuotat e përcaktuara çdo vit nga departamenti përkatës dhe të miratuara nga Bordi i Administrimit. Cdo student ka të drejta të barabarta, të parashikuara këto në marrëveshjen me institucionin. Evidenca 5.2. Procedura e pranimit të studentëve të huaj

	Evidenca 5.3. Lista e studentëve të huaj gjatë vitit akademik 2024-2025, 2023-2024, 2022-2023.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	WBU harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për t'u pranuar në programet specifike të studimeve janë përcaktuar në Statutin dhe në Rregulloren e WBU, si dhe në Rregulloret përkatëse të çdo programi studimi. WBU bashkëpunon me strukturat për zbatimin e maturës shtetërore, si Matura Shtetërore dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, dhe me U-Albania, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse të strukturave të tjera përgjegjëse për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. WBU mund të propozojë kriteret të veçanta të konkurseve të pranimit për çdo specialitet, të cilat bëhen publike së bashku me informacione të tjera të nevojshme. Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Western Balkans", Nenet 83,87,92 dhe 94. Evidenca 1.2. Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans", Nenet 54-59.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Nga regjistrimi deri në diplomim studentët bazohet në procedura transparente. Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve janë përcaktuar në Statutin e WBU dhe në Rregulloren e WBU. Kriteret e transferimit dhe të njohjes së krediteve dhe të studimeve të kryera në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit janë përcaktuar në Statutin e WBU, në Rregulloren e WBU, në Rregulloren "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë", si dhe në rregulloren e programit të studimi. Mënyrat dhe procedurat e vlerësimit të përparimit të studentëve, janë përcaktuar gjithashtu në të njëjtat dokumenta të IAL. Nëpërmjet Javës së Orientimit Akademik studentët informohen për procedurat e vlerësimit si dhe në javën e parë të mësimit në cdo lëndë, gjatë vënies në dispozicion të sylabusit. Studentët mund të kërkojnë informacione shtesë nga këshilltari akademik, koordinatori i programit dhe përgjegjësi i departamentit. Evidenca 3.1. Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë".

	Evidenca 5.4. Ditët e informimit brenda institucionit për studentët/ organizimi i aktiviteteve informuese.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik WBU informon të interesuarit mbi kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për programet akademike që ai ofron. Kriteret bëhen publike në faqen web të WBU për programin e studimit. Kriteret e veçanta për përzgjedhjen dhe pranimin e kandidatëve për studentë në programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Teknik Laboratori", janë hartuar nga Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazheri, sipas objektivave të PS, të përcaktuara në Rregulloren e PS, dhe janë miratuar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Kandidatët për studentë mund të kërkojnë informacion edhe nga Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve, Dekanati i Studentëve, këshilltari akademik, koordinatori i departamentit, koordinatori i programit dhe përgjegjësi i departamentit, për probleme specifike. Për informimin e studentëve IAL ka hartuar dhe publikuar Guidën e studentit. WBU merr pjesë në panairë të ndryshme të organizuara brenda dhe jashtë vendit, ku informon kandidatët për studentë mbi ofertën akademike dhe kriteret e nevojshme. Ky komunikim zhvillohet edhe online, në platforma të ndryshme. Përmes SMART-WBU, si dhe përmes fq zyrtare web, institucioni ka krijuar një sistem të posaçëm në shërbim të informimit, ku studenti ka akses dhe gjen informacion të plotë në lidhje me të dhënat për programin e studimit, mbarëvajtjen e tij, materialet didaktike, vlerësimet, etj. Ndërkohë përmes faqes zyrtare web dhe njoftimeve të herëpashershme, të interesuarit për studentë marrin një informacion të plotë për çdo detaj. Evidenca 2. Rregullorja e Programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Teknik Laboratori" në Universitetin "Western Balkans"
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	WBU pranon edhe studentë me aftësi të veçanta, nga pakicat dhe nga shtresat e tjera për të cilët ka kuota të veçanta. Edhe infrastruktura mundëson aksesin e këtyre kategorive të studentëve në ambjentet e WBU dhe përdorimin e tyre. Ndërkombëtarizimi i universitetit jo vetëm përmes angazhimit të personelit akademik dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione jashtë vendit, por edhe përmes prurjes në Shqipëri të studentëve nga vende të ndryshme është një prioritetet i WBU. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga

	shtete të tjera hartohen dhe publikohen online çdo vit akademik, si dhe vihen në dispozicion në panaiet e ndryshme që WBU merr pjesë jashtë vendit.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Kriteret për përzgjedhjen, pranimin dhe regjistrimin e kandidatëve nga shtete të tjera janë përcaktuar në Rregulloren e WBU. Për studentët e huaj WBU ka hartuar një procedurë të veçantë, ku janë përcaktuar kriteret specifike për pranimin në një nga programet e studimit. Në ndihmë të studentëve të huaj janë tre zyra të posaçme, Zyra e Marketingut dhe Pranimeve, Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve, si dhe Zyra e Studentëve Ndërkombëtarë. Studentët e huaj informohen në lidhje me ofertën akademike, dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim, si edhe informacione të tjera që lidhen me jetën akademike, specifikat e vendit, kulturës, institucioneve, etj., dhe organizon edhe aktivitete sociale. <i>Evidenca 5.2. Procedura e pranimit të studentëve të huaj</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	WBU publikon dhe përditëson periodikisht të dhënat në lidhje me tarifat e studimit, kategoritë e bursave dhe bursat nga institucionet partnere. Sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet partnere, WBU ofron mbështetje për studentët e kategorive të ndryshme. WBU ka hartuar politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë. Përcaktimi i llojeve të bursave, mënyra e vlerësimit dhe akordimi i tyre parashikohet nga Rregullorja e Bursave. WBU mundësohen bursa ekselence, bursa institucionale, si edhe bursa studimi për maturantët që vijnë nga zona të veçanta në vend. Zyra e Bursave në Dekanatin e Studentëve është njësia përgjegjëse për ndjekjen e të gjithë procesit të akordimit dhe të kontrollit të bursave, bazuar në notën mesatare të studentëve. Konkretisht 25 bursa janë përfutur nga studentët të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Teknik Laboratori”. <i>Evidenca 4.17. Lista e institucioneve akademike partnere</i> <i>Evidenca 5.9. Marrëveshja me prespektivat e reja për bursat.</i>
Konkluzione	<i>Konstatohet se në kuadrin rregullator të WBU parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në PS dhe procedurat lidhur me ecurinë e tyre deri në diplomim.</i> <i>WBU ka mundësuar hartuar kuota të pranimit për kategori të veçanta si për kandidatët nga trojet, pakicat kombëtare,</i>

	kandidatët ndërkombëtarë, etj. WBU publikon dhe përditëson periodikisht të dhënat në lidhje me tarifat e studimit, kategoritë e bursave dhe bursat nga institucionet partnere. WBU ofron mbështetje për studentët e kategorive të ndryshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	WBU mundëson informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Statuti i WBU përcakton sasinë mesatare të krediteve të grumbulluara gjatë një viti për kalimin në vitin pasardhës. Kalimi nga njëri vit tek tjetri bëhet pasi studenti të ketë shlyer detyrimet e vitit të mëparshëm, në përputhje me Rregulloren e WBU, në Rregulloren “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë”, si dhe në rregulloren e PS. <i>Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit “Western Balkans”, Neni 84, Pika 3</i> <i>Evidenca 1.2. Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans”, Neni 90</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	WBU informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Kriteret e transferimit dhe të njohjes së krediteve dhe të studimeve të kryera në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit specifikohen në Statutin e WBU, në Rregulloren e WBU, në Rregulloren “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë”, dhe në Rregulloren për njohjen dhe transferimin e studimeve, ku përcaktohen në detaje parimet dhe procedurat që ndiqen nga WBU për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve. Të interesuarit për transferimin dhe ndjekjen e studimeve në një nga programet e studimit të WBU njihen me kriteret dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	procedurën që duhet të ndiqet për njohjen e kualifikimeve të mëparshme. Njohja e krediteve bëhet nga një komisioni <i>ad-hoc</i> i ngritur nga departamenti përgjegjës për programin e studimit. Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit “Western Balkans”, Nenet 91,95,104 dhe 105 Evidenca 1.2. Rregullorja Themelore e Universitetit “Western Balkans”, Nenet 67, 68, 70 dhe 71
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Sistemi i vlerësimit të studentëve, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore në WBU janë përcaktuar në Rregulloret e WBU dhe të Programit të Studimit, ku janë përcaktuar të gjitha modalitetet. Sistemi dhe kriteret e vlerësimit bëhen publike dhe njihen nga studentët që në javën e parë të zhvillimit të mësimi. Kriteret, komponentët e vlerësimit dhe mënyra e vlerësimit përcaktohen në sylabusin e lëndës dhe bëhen publike për studentët e programit. Në fillim të çdo lënde studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara nga titullari i lëndës/modulit. Sylabusi i lëndës/modulit ngarkohet në platformën SMART-WBU https://smart.wbu.edu.al/ dhe/ose në Google Classroom, të aksesueshme në çdo kohë nga studentët.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	WBU tregon një kujdes të veçantë në formalizimin e procedurave që ndihmojnë studentët në jetën studentore nga regjistrimi në një program studimi e deri në diplomim. Studentët kanë mundësi të njihen me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimin në programin e studimit. Sipas Rregullores së WBU, studenti që shlyen të gjitha detyrimet akademike ka të drejtë të hyjë në mbrojtjen e diplomës. Diplomimi bëhet pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike. Diplomimi mund të bëhet me provim ose me temë diplome. Diploma është përcaktuar si lëndë e veçantë me një numër të caktuar kreditesh në kurrikulat e të gjitha programeve të studimit dhe janë të publikuara në faqen e web-it të WBU, ku studentët mund të informohen në çdo kohë. Modalitetet mbi detyrimet përmbyllëse të studentëve për të gjitha ciklet e studimit janë përcaktuar gjithashtu në Statutin e WBU, dhe në Rregulloret përkatëse. Për realizimin e temës së diplomës njësia bazë cakton një udhëheqës shkencor, i cili asiston studentin gjatë periudhës së kërkimit.

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	WBU ka ngritur struktura të veçanta ku Zyra e Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimi të Studentëve mundëson njohjen e WBU në të gjitha nivelet. Kjo zyrë organizon përgatitjen e të gjitha materialeve prezantuese, publikimin e informacionit në web dhe në sistemin e teknologjisë së informacionit. Kjo zyrë ka detyrë prezantimin e WBU edhe në panairë të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ku përmes materialeve promovuese si Guida e studentit, informon kandidatët e interesuar mbi specifikat e PS. WBU i jep rëndësi edhe komunikimit digjital, me ofrimin e një ransparence të plotë përmes faqes së web-it, dhe në rrjetet sociale të universitetit, me informacione të detajuara mbi ofertën akademike, personelin akademik, tarifat e studimit, bashkëpunimi me institucionet partnere, mundësitë e bursave të studimit, rregulloret institucionale, vlerësimet periodike, etj. Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve në fillim të çdo viti akademik, organizon javën orientuese për studentët e rinj, duke i njohur ata me informacionet e nevojshme. Strukturat e njësive bazë dhe kryesore, me anë të këshilltarit akademik, mbikëqyrin vijueshmërinë e suksesshme akademike të studentëve. Ka disa zyra si Zyra e Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimin e Studentëve koordinon punën me Zyrën e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve përgjegjëse për informimin e studentëve të ardhshëm, promovimin e programeve të studimit dhe këshillimin e karrierës. Ditët e hapura të informimit organizohen gjatë gjithë vitit akademik. Informacionet shpërndahen në faqen zyrtare të WBU dhe në rrjetet sociale të universitetit. <i>Evidenca 5.6. Guida e studentit</i> <i>Evidenca 5.16. Raport mbi veprimtarinë e Zyrës së Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimi të Studentëve për vitin akademik 2022-2023, 2023-2024</i> <i>Evidenca 5.4. Ditët e informimit brenda institucionit për studentët/organizimi i aktiviteteve informuese</i>
Konkluzione	WBU siguron transparencë dhe akses të plotë për studentët mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik përmes platformës SMART-WBU, si dhe mbi procesin e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Studentët marrin informacion të detajuar mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në këtë program studimi dhe procedurat e

	<i>diplomimit. Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve në fillim të çdo viti akademik, organizon javën orientuese për studentët e rinj, duke i njohur ata me informacionet e nevojshme për jetën akademike dhe studentore. Informimi dhe mbështetja e studentëve vazhdon gjatë gjithë vitit akademik. Strukturat e njësive bazë dhe kryesore, me anë të këshilltarit akademik, mbikëqyrin ecurinë akademike të studentëve, koordinojnë punën me zyrat përgjegjëse për informimin e studentëve të ardhshëm, promovimin e programeve të studimit dhe këshillimin e karrierë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Nga vizitat në IAL, gjv konstaton që studentët e çdo programi studimi që ofrohet në WBU informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit që në momentin e aplikimit për një program të caktuar studimi. Detaje të hollësishme mbi strukturën, organizimin, kohëzgjatjen, vlerësimin në kredite, etj., janë të përcaktuara në kurrikulën e çdo programi studimi, janë publike dhe lehtësisht të aksesueshme nga web-i i Universitetit në gjuhën shqipe https://wbu.edu.al/sq/ dhe në gjuhën angleze https://wbu.edu.al/en. Informacion u vihet në dispozicion studentëve edhe i printuar që në momentin e regjistrimit nga Sekretaria Mësimore, koordinatori i programit, nga departamenti apo strukturat e tjera të universitetit. Forma e organizimit të studimeve, mënyra, gjuha e përdorur në mësimdhënie në programet e studimit, viti akademik, etj, në mënyrë të detajuar, janë të përcaktuara në Statutin e WBU dhe në rregulloret përkatëse. Për programin e studimit Bachelor në “Teknik Laboratori” ky informacion gjendet në linkun: https://wbu.edu.al/public/sq/program/laboratory-technician në gjuhën shqipe dhe https://wbu.edu.al/en/program/laboratory-technician në gjuhën angleze). Informacione të hollësishme mbi strukturën,

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	organizimin, kohëzgjatjen, vlerësimin në kredite, etj., sigurohen edhe nga Rregullorja e PS. Cdo departament cakton një anëtar të stafit akademik me kohë të plotë si këshilltar akademik, roli i tij është të mbështesë dhe të orientojë studentin gjatë gjithë periudhës së arsimimit në Universitet. Evidenca 5.17. Procedura e regjistrimit të studentëve Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit "Western Balkans", Nenet 82-86 Evidenca 5.6. Guida e studentit
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në momentin e regjistrimit studenti pajiset me Guidën e Studentit, e cila ka informacione të përgjithshme mbi institucionin. Studentët e regjistruar në programet e studimit pajisen me të gjithë informacionin e nevojshëm mbi lëndët/modulet, përmbajtjet dhe veprimtaritë formuese. Në funksion të studentëve janë edhe këshilltarët akademikë, të cilët i njohin ata me informacionet e detajuara për cdo gjë. Plani mësimor gjendet i detajuar edhe në faqen e internetit të WBU, në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, së bashku me sylabuset përkatëse, të cilat vihen në dispozicion të studentëve që në javën e parë. Platforma SMART-WBU, ku studentët kanë akses të plotë është në ndihmë të studentëve. Informacionet mund t'u vihen në dispozicion studentëve edhe në formë të printuar, para regjistrimit dhe të aplikimit nga sekretaria, nga koordinatori i programit, departamenti dhe strukturat e tjera të universitetit. Përmes platformës SMART-WBU https://smart.wbu.edu.al/, institucioni ka krijuar një sistem të posaçëm në shërbim të informimit, ku çdo student, nëpërmjet adresës zyrtare të komunikimit të brendshëm elektronik, ka akses dhe gjen informacion të plotë. Strukturat e njëjësive bazë dhe kryesore, me anë të këshilltarit akademik, mbikëqyrin vijueshmërinë akademike të studentëve. Evidenca 5.6. Guida e studentit Evidenca 5.19. Praktika e një rast këshillimi karriere nga Zyra e Pranimitt ë Karrierës
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për	Për një integrim sa më të lehtë në tregun e punës pas diplomimit, studentët e WBU asistohen në mënyrë të vazhduar nga Zyra e Planifikimit të Karrierës, e cila varet nga Dekanati i Studentëve. Kjo zyrë krijon lidhjet e duhura midis universitetit, institucioneve publike dhe private, kombëtare

orientimin drejt dhe në tregun e punës.	dhe ndërkombëtare me synimin kryesor orientimin e studentëve drejt tregut të punës, duke bërë të mundur që këto institucione të përthithin staf cilësor dhe të angazhuar. Përmes këshilltarëve të karrierës, studentët bëhen pjesë edhe të trajnimeve të ndryshme me karakter profesional. Zyra e Planifikimit të Karrierës bën të mundur dhe këshillime individuale apo në grup për të gjithë studentët që kanë nevojë për mbështetje gjatë karrierës së tyre. Ajo ndan informacionin dhe organizon eventet që kanë të bëjnë me karrierën e ardhshme të studentëve. Vlen të përmendim mundësitë që janë krijuar për përvetësimin e njohurive përmes programit EPIC. Gjithashtu Zyra e të Diplomuarve është ura lidhëse midis universitetit dhe të diplomuarve prej tij. Kjo zyrë bën gjurmimin e të diplomuarve në tregun e punës, krijimin e një rrjeti të gjerë komunikimi dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme me ta. <i>Evidenca 1.10. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans", Neni 47</i> <i>Evidenca 5.19. Praktika e një rast këshillimi karriere nga Zyra e Pranimitt ë Karrierës</i> <i>Evidenca 1.10. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans", Neni 48</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Personeli i WBU-së dhe studentët janë të pajisur që të gjithë me adresa zyrtare të komunikimit të brendshëm elektronik. Ky informacion mund të aksesohet edhe nga Guida e Studentit, përmes kanaleve të komunikimit digjital, si SMART-WBU, faqja e internetit të institucionit, komunikimi i rregullt me këshilltarët akademik, apo me koordinatorin dhe përgjegjësën e programit, etj. Përmes SMART-WBU studenti ka akses dhe merr informacion të plotë në lidhje me programin e studimit, mbarëvajtjen e tij, materialet didaktike, vlerësimet, etj. Këshilltarët akademikë ndihmojnë në orientimin dhe dhënien e informacioneve për çështje të ndryshme.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm	SMART-WBU është një mundësi shumë e mirë për të aksesuar informacionin e nevojshëm të studentëve mbi programin e studimit ku ata janë regjistruar. Ky informacion ofrohet në shqip dhe anglisht dhe mund të aksesohet nëpërmjet llogarive personale të studentëve.

të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni mbi programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Teknik Laboratori" mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit në faqen web (https://wbu.edu.al/public/sq/program/laboratory-technician në gjuhën shqipe dhe https://wbu.edu.al/en/program/laboratory-technician në gjuhën angleze , në platformën SMART-WBU https://smart.wbu.edu.al/ , Google classroom, nëpërmjet llogarive personale të studentëve. Cdo informacion lidhur me programet e studimit është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.			
Konkluzione	<i>Struktura dhe organizimi i programit janë të dhëna publike që mund të aksesohen nga studenti online apo nëpërmjet broshurave, ose nëpërmjet komunikimit me koordinatorin e programit. Organizimi i takimeve, ditëve të hapura dhe ofrimi i informacionit përmes kanaleve të ndryshme informative garanton një integrim të suksesshëm të studentëve në program dhe krijimin e mundësive për zhvillimin e tyre profesional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni nëpërmjet strukturave përgjegjëse (Sekretaria Mësimore, koordinatori i departamentit, etj.), mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin dhe profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Mbarëvajtja e studentëve bëhet gjithashtu edhe pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë në fund të çdo viti akademik.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre,	Strukturat përgjegjëse për organizimin e programit të studimit, Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazheri dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, kanë statistika vjetore të detajuara mbi numrin e studentëve të regjistruar, përparimin e tyre deri në diplomim, si dhe rastet e largimeve para përfundimit të programit ose mosmbarimit me

tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	sukses të vitit akademik. Këto të dhëna paraqesin dinamiken e regjistrimeve dhe përfundimeve të studimeve, duke mbështetur analizën dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Të dhënat përditësohen nga sekretaria mësimore, e cila ndjek rrugëtimin e çdo studenti nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve. Ato paraqiten në mënyrë statistikore në raportet vjetore të njësive bazë dhe ato në nivel institucional. <i>Në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknik Laboratori”, vitin akademik 2022-2023 (viti i parë i hapjes së programit) janë regjistruar 11 studentë vetëm në gjuhën Angleze, për vitin akademik 2023-2024 11 studentë programi në gjuhën Shqipe / 6 në gjuhën Angleze për vitin e dytë akademik 17 totali, dhe për vitin akademik 2024-2025 në total 13 studentë nga të cilët, 6 studentë gjuha Shqipe/ 7 gjuha Angleze.</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Mbledhja dhe përpunimi i statistikave menaxhohet nga Sekretaria Mësimore. Sipas Rregullores mbi organizimin administrativ, Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti ose transkripti, lidhur me studentët. Nëpërmjet platformës SMART-WBU https://smart.wbu.edu.al/, institucioni ka bërë digjitalizimin e dokumentacionit sipas njësive prodhuese. WBU disponon bazë të dhënash mbi regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimit, të dhëna të përgjithshme për programin, formën, planin mësimor, kreditet e detyrueshme të studimeve. Dokumentet ruhen dhe administrohen nga dekanati dhe njësitë bazë. Ato publikohen online në web dhe ngarkohen të plota në SMART-WBU. Sekretaria mësimore mban regjistrin bazë të studentëve me të dhënat personale, regjistrin bazë në formë të shkruar dhe elektronike për vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, si dhe regjistrin për diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës. Të dhënat janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të	WBU, përveç auditimit financiar, bën edhe kontrollin periodik/auditimin e brendshëm lidhur me përputhshmërinë me përcaktimet ligjore dhe aktet e brendshme të njësive

Evidenc: Vizita në IAL (sekretaria mësimore)


Evidenca 3.30. Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore, Neni 3

përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), si dhe vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. Çdo kontroll apo auditim periodik i brendshëm shoqërohet me një raport, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese të institucionit, për përmirësimin e situatës nëse konstatohen probleme. Evidenca 4.41. Raporti i auditimit të brendshëm të WBU 2023			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Njësia bazë, Departamenti i Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazheri, njësia përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknik Laboratori”, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e të Diplomuarve (Alumni), harton raporte të hollësishme dhe të vazhdueshme mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe detaje të punësimit të tyre. Sekretaria Mësimore administron dhe menaxhon të dhënat e studentëve në hyrje dhe në dalje. Zyra e të Diplomuarve është ura lidhëse midis universitetit dhe të diplomuarve; ajo bën gjurmimin e punësimit të të diplomuarve. Të dhënat pasqyrohen në raportin vjetor të punës së departamentit dhe shërbejnë për marrjen e masave për përmirësimin e këtyre treguesve. Evidenca 1.10. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit “Western Balkans”, Neni 31 Evidenca 3.30. Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore, Neni 3 Evidenca 5.21. Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazherisë 2023-2024			
Konkluzione	Rezulton se WBU harton raporte me statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar dhe transferuar. Sistemi i brendshëm i informacionit mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe siguron ruajtjen e tyre, sipas standarteve të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në Rregulloren Themelore të WBU parashikohet e drejta e organizimit të studentëve në këshilla studentorë, përfshirja dhe angazhimi i tyre ose i përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. Studentët inkurajohen në pjesëmarrjen në jetën institucionale. Senati Akademik i WBU ka në përbërje 2 studentë, përfaqësues të Këshillit Studentor. Studentët janë gjithashtu anëtarë në komisionet e përhershme në nivel institucioni apo në nivel fakulteti, ku janë anëtarë me të drejta të plota dhe pjesëmarrës periodikisht në mbledhjet e dekanateve dhe njësi bazë. Ata përfaqësohen gjithashtu edhe në Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Studentët janë pjesë e hartimit të raporteve të rëndësishme institucionale, si Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional. Studentët organizohen në Këshillin Studentor me anë të Zyrës së Koordinimit të Klubeve Studentore, pranë Dekanatit të Studentëve, mbështet punën e studentëve që duan të organizohen në klube studentore në fusha të ndryshme akademike, sociale, kulturore, artistike dhe sportive. <i>Evidenca 1.2. Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 10</i> <i>Evidenca 5.22. Përfshirja e studentëve në Senatin Akademik</i> <i>Evidenca 5.23. Pjesëmarrja e studentëve në organet kolegjiale</i> <i>Evidenca 5.25. Praktika e Zgjedhjeve e Këshillit Studentor 2022.</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me	Këshilli Studentor i WBU është një organ i pavarur, i cili ka Statutin e tij, me qëllim përfaqësimin e interesave të studentëve. Këshilli studentor bën propozime rreth çështjeve që lidhen me interesin e studentëve dhe angazhohet në përfaqësimin e tyre në organet më të larta drejtuese të universitetit. Këshilli zgjidhet në mënyrë demokratike dhe përfaqëson interesat e të gjithë studentëve pa dallime mes tyre.

rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Këshilli përcjell zërin e studentëve duke nxitur pjesëmarrjen e studentëve në vendime që kanë të bëjnë me strukturat mësimore-shkencore. Kryetari i këshillit studentor merr pjesë në organet vendimmarrëse të institucionit si përfaqësues i studentëve. Përfaqësuesit e studentëve në organet kolegjiale brenda institucionit shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm. <i>Evidenca 1.10. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans", Neni 49</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Përfshirja e studentëve, përmes disa formave mbi përmirësimin e vazhduar të programeve të studimit, është parë me përparësi në WBU. Studentët bëhen pjesë e këtyre proceseve përmes vlerësimeve periodike mbi performancën e pedagogëve, natyrën dhe përmbajtjen e lëndëve, mbi të gjithë programin kur ata janë në prag diplomimi, apo përmes një vlerësimi të planifikuar për t'u kryer pas punësimit të tyre. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programet e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ dhe studentëve. Njësia bazë, në hartimin dhe implementimin e PS i përgjigjet standardeve të cilësisë të përgatitura nga NJSBC dhe të miratuara nga organet kompetente. Përfaqësuesi i studentëve, ftohet të marrë pjesë në mbledhjet e organizuara nga NJSBC. <i>Evidenca 5.28. Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës përfaqësuesin e kllasës (Senatorin) e programit të studimit në Njësinë Bazë</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Institucioni i ka të përcaktuara qartë rregullat dhe detyrimet e provimeve, si dhe ankimimin e rezultateve, me të cilat studentët njihen përmes rregulloreve përkatëse të publikuara në faqen zyrtare të IAL-së. Studentët japin mendim mbi barazinë dhe ntransparencën në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit dhe rishikimit. Rezultatet e arritura në çdo lëndë i dorëzohen pjesës administrative të departamentit, brenda afatit të përcaktuar në kalendarin akademik. Rezultatet publikohen në faqen personale të studentëve. Sipas Rregullores në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve të paraqesë një ankesë me shkrim tek Zyra e Sekretarisë Mësimore.

Reflektuar



	Ankimi shqyrtohet nga një komision i ngritur nga Departamenti përkatës, ky komision përbëhet prej tre pedagogë. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit brenda 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Evidenca 2.1. Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë”, Neni 28			
Konkluzione	WBU angazhon studentët në vendimmarrje duke i dhënë mundësi të shprehin mendimet e tyre edhe për barazinë dhe transparencën në kontrollin e dijeve dhe në vlerësim. Studentët kontribuojnë në hartimin, miratimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve. Studentët kanë përfaqësuesin e tyre në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës dhe në NJSBC. Përfaqësuesi i studentëve merr pjesë në mbledhjet e organizuara nga njësitë apo zyrat përkatëse, me qëllim transmetimin e opinionit dhe mendimit të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	WBU ka një sistem të menaxhimit të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve, i cili bazohet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit nëpërmjet të cilit administron gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, e më pas. Menaxhimi i të gjithë informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, përcaktohet në Statutin dhe në Rregulloren e WBU. WBU ruan kopje fizike dhe në formë elektronike të dokumentacionit të studentit, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Sipas Rregullores së Universitetit “Western Balkans”, Zyra e Protokollit dhe Korrespondencës është zyra përgjegjëse për

	arkivimin, administrimin, ruajtjen dhe përdorimin e efektshëm të dokumenteve të krijuara nga organet drejtuese dhe njësitë e institucionit. Mbledhja dhe përpunimi i statistikave realizohet nga zyrat administrative (Sekretaria Mësimore dhe Burimet Njerëzore). Zyra e Sekretarisë Mësimore është përgjegjëse për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti ose transkripti, lidhur me studentët. Nëpërmjet platformës SMART-WBU institucioni ka siguruar digjitalizimin e dokumentacionit. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave të studentëve nga Universiteti dhe strukturat përbërëse të tij bazohet në parimin e konfidencialitetit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale të përcaktuara në Statutin e WBU dhe në Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. <i>Evidenca 1.10. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans", Neni 4</i> <i>Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit "Western Balkans", Neni 122</i> <i>Evidenca 3.30. Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Ka një strukturë të orientimit dhe këshillimit për studentët. Sistemi përbëhet nga një sistem i dhënies së informacionit/kthim përgjigje në mënyrë elektronike si dhe dhënien e informacionit nga strukturat ndihmës-akademike dhe administrative për studentët dhe stafin. Zyrën e Komunikimit, dhe ka një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimin e Studentëve siguron prezantimin në të gjitha nivelet, organizon përgatitjen materialeve prezantuese, publikimin e informacionit në web dhe në sistemin e teknologjisë së informacionit dhe përditësimin e tij. Dekanati i Studentëve ka një zyrë të dedikuar, Zyrën e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve. Kjo zyrë ndihmon studentët të respektojnë procedurat dhe rregulloret e universitetit, i orienton ata që të shfrytëzojnë burimet e kampusit universitar dhe mbështet studentët përgjatë jetës studentore. Zyra e Studentëve Ndërkombëtarë mbështet gjithashtu të gjithë studentët e huaj pjesë e WBU me dhënien e informacioneve të nevojshme, mbështetjen e tyre deri në përfundimin e studimeve universitare dhe më tej. Informacioni mbi

	njoftimet, thirrjet publike, aktivitetet, publikohet në faqen zyrtare (www.wbu.edu.al) dhe në rrjetet sociale. Të gjitha procedurat në lidhje me aplikimin për të përfituar bursë gjenden të publikuara online https://wbu.edu.al/en/scholarships. Përveç SMART-WBU, platforma Google Classroom përdoret për ngarkim të materialeve mësimore për studentët, nga ana e personelit akademik. Studentët në çdo rast mund t'i drejtohen Dekanit të Studentëve. Procesin mësimor, një rol të rëndësishëm luan këshilltari akademik, i cili caktohet në çdo fillim viti për çdo grup studentësh. Evidenca 1.10. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans", Neni 33
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Dekani i studentëve përgjegjës për mbarrëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me institucionin dhe me tregun e punës. Dekanati i Studentëve ka një zyrë të dedikuar, Zyra e Planifikimit të Karrierës e cila i orienton studentët gjatë dhe përtej jetës akademike në kampus. Zyra e Planifikimit të Karrierës krijon lidhjet e duhura midis universitetit, institucioneve publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare me synimin kryesor orientimin e studentëve drejt tregut të punës, duke lehtësuar integrimin e tyre dhe duke bërë të mundur që këto institucione të përthithin staf cilësor dhe të angazhuar. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Zyra e Planifikimit të Karrierës bën të mundur takime këshillimi individuale si edhe takime këshillimore në grup për të gjithë studentët që kanë nevojë për mbështetje gjatë procesit të planifikimit të karrierës së tyre. WBU mbështet zhvillimin dhe aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët, nëpërmjet programit EPIC. Përfitues janë të gjithë studentët e WBU që studiojnë në një nga programet e studimit. Evidenca 5.19. Praktika e një rasti këshillimi karriere nga Zyra e Planifikimit të Karrierës
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët	Zyra e të Diplomuarve, e cila është ura lidhëse midis universitetit dhe të diplomuarve prej tij. Megjithatë akoma nuk

pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	ka të diplomuar nga ky program studimi, kjo zyrë parashikohet të bëjë gjurmimin e të diplomuarve në tregun e punës, krijimin e një rrjeti të gjerë të komunikimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme me ta. Zyra do të ndjeke studentët pas diplomimit, duke mbledhur e përpunuar të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit.			
Konkluzione	<i>WBU ka ngritur njësi për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve. Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet nga Qendra e Këshillimit të Karrierës, e cila harton edhe raporte mbi punësimin e studentëve. Këshilltarët e karrierës i ndihmojnë studentët në zhvillimin e strategjisë së planifikimit të karrierës, në përgatitjen e dokumenteve të nevojshme për aplikim për punë etj. Gjithashtu, sigurojnë mundësi takimi me persona përgjegjës të institucioneve që kërkojnë të punësojnë staf dhe të marrin informacion rreth profileve të kërkuara prej tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në WBU u përgjigjet nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Institucioni ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	studimeve, lëndëve/moduleve. Procesi mësimor përbëhet nga leksionet, punët në laborator, praktikat mësimore, vizitat studimore në terren apo në labore të ndryshme, seminarët, testet e shkurtra, punët individuale (detyra kursi e projekte, në varësi të lëndës), dhe punime të tjera të ngjashme, të parashikuara në programin mësimor të secilës lëndë / modul. Kombinimi i të gjitha metodave alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies bëjnë që procesi mësimor të zhvillohet normalisht dhe të arrihen objektivat e programeve të studimit. Personelin akademik mbështetës në përmirësimin e kompetencave didaktike, duke zbatuar politika të qarta për promovimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm akademik dhe ndihmës akademik. Personeli akademik dhe ndihmës akademik i nënshtrohet procedurave të trajnimit dhe kualifikimit, me qëllim rritjen e kapaciteteve në mësimdhënie. <i>Evidenca 1.2. Rregullorja Themelore e Universitetit “Wester Balkans”, Neni 75, pikat 4-6</i> <i>Evidenca 2.7. Sylabus i lëndëve të programit</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Mekanizmat për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies konsiston në zhvillimin e monitorimit dhe vlerësimit periodik të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Strukturat përgjegjëse në WBU zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Në WBU funksionon Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit, i cili bashkërendon punën e tij me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Përbërja dhe kompetencat e kësaj njësie përcaktohen në Statutin e WBU. Mënyra e funksionimit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përcaktohet në rregulloren përkatëse të miratuar nga Senati Akademik. Kjo njësi kryen vlerësime periodike mbi performancën e stafit akademik në cilësinë e mësimdhënies dhe vlerësimin e programit të studimit. Raportet publikohen dhe në fund të procesit NJSBC jep rekomandimet përkatëse. Propozimet për ndryshime të elementëve të programeve të studimit diskutohen në njësite bazë dhe janë pjesë të analizës vjetore të tyre. <i>Evidenca 3.7. Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit</i>

	Evidenca 3.8. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit Evidenca 3.9. Vendimi për ngritjen e NJSBC Evidenca 2.8. Paketa e instrumenteve të cilësisë
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	WBU i kushton rëndësi vlerësimit dhe përmirësimit të metodave të mësimdhënies, duke përfshirë në këtë proces studentët aktualë, ata në prag diplomimi dhe të diplomuarit. Kjo siguron efektivitetin e metodave të mësimdhënies dhe përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave akademike, në përputhje me kërkesat e studentëve dhe tregut të punës. Pra, IAL mundeson përfshirjen e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. Studentët janë pjesë e procesit të vlerësimit të personelit akademik, nëpërmjet pyetësorëve që organizohen në fund të çdo semestri, për çdo lëndë dhe çdo pedagog, duke vlerësuar edhe performancën e lektorit dhe përmbajtjen e lëndës. Pyetësorët kanë pyetje të ndryshme për të tërhequr sa më shumë mendimin e studentëve për vlerësimin real dhe përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies, duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. Të dhënat e grumbulluara nga vlerësimi i studentëve nëpërmjet pyetësorëve për cilësinë e mësimdhënies iu vihen në dispozicion organeve drejtuese për të ndërmarrë iniciativa apo procedura me qëllim përmirësimin e punës në vijim. Studentët kanë të drejtën e ankimit, percaktuar kjo edhe ne Rregulloret e ndryshme që percaktojnë afatet dhe mënyrën e ankimit dhe të trajtimit dhe të zgjidhjes së ankës. Evidenca 6.1. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët Evidenca 3.6. Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik Evidenca 2.10. Paketa e instrumenteve të cilësisë
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	NJSBC e WBU ka një rubrikë të dedikuar në faqen web të institucionit. Kjo rubrikë është krijuar që të informojë në lidhje me politikat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në WBU, organizimin e njësisë dhe planin e saj vjetor të punës. Në këtë rubrikë publikohen raportet vjetore të NJSBC-së në zbatim të transparencës, për studentët, stafin dhe gjithë të interesuarit. Rezultatet e vlerësimit të mësimdhënies bëhen publike nga strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të

	Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit dhe NJBSC në raportimet periodike. Ato mund të aksesohen po ashtu edhe në faqen web të IAL. <i>Evidenca 3.8. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit</i> <i>Evidenca 6.2. Rast i planit të masave të ndërmarra nga institucioni bazuar në raportet e vlerësimit të hartuar nga NJSBC</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	WBU promovon shembujt e praktikave të mira dhe nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, zbatohet një strategji për promovimin e teknikave më bashkëkohore me takime me profesionistë të suksesshëm. Departamentet organizojnë leksione të hapura nga anëtarë të stafit, me pjesëmarrjen e personelit akademik dhe studentëve, duke krijuar mundësi për shkëmbim të njohurive dhe përmirësim të vazhdueshëm në fushën akademike. Rregullorja mbi punësimin dhe vlerësimin e performancës së stafit përcakton që anëtarët e stafit akademik me performancë të lartë akademike të përzgjidhen për promovim akademik brenda njësive bazë dhe njësive kryesore akademike. WBU ka hartuar një Udhëzim për Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor për mbështetjen financiare nga institucioni në rast të publikimeve dhe pjesëmarrjes në aktivitete kërkimore-shkencore. Institucioni ofron mbështetje financiare të personelit edhe për pjesëmarrje në aktivitete kërkimore-shkencore. <i>Evidenca 6.5. Plani vjetor i aktiviteteve të departamentit të Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazherisë 2024-2025</i> <i>Evidenca 4.13. Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit</i> <i>Evidenca 6.6. Udhëzim mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor</i> <i>Evidenca 6.8. Praktikë e mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca</i>
Konkluzione	IAL ka krijuar struktura të qarta për të garantuar dhe promovuar cilësinë e mësimdhënies. Politika për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në WBU konsiston në zhvillimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit periodik të aftësive mësimdhënëse të personelit

	<i>akademik dhe ndihmësakademik, me bashkëveprimin e disa strukturave. WBU inkurajon aktivisht përfshirjen e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	WBU ka hartuar politika, ka ngritur struktura dhe ka hartuar procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), sipas parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit është përgjegjës për hartimin e procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik. Ky komision bashkërendon punën e tij me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila, kryen vlerësime periodike mbi performancën akademike, vlerësimin e studentëve, vlerësimin e personelit akademik, ndihmës akademik apo administrativ. NJSBC ka në përbërje të saj 5 anëtarë, një përfaqësues nga secili fakultet, një përfaqësues të studentëve dhe një ekspert i jashtëm. <i>Evidenca 3.8. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programve të Studimit</i> <i>Evidenca 2.10. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 3.10. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët	Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit e bashkërendon me NJSBC e cila kryen vlerësime periodike mbi performancën akademike dhe vlerësimin e programit të studimit. Në sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programet e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës-akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Përfaqësuesi i studentëve, ftohet të marrë pjesë në mbledhjet e organizuara nga NJSBC për transmetimin e opinionit dhe mendimit të studentëve. Pas çdo vlerësimi, NJSBC harton raportet e vlerësimit, të cilat bëhen publike. Në përfundim të procesit të vlerësimit, NJSBC jep rekomandimet përkatëse. Në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë përfshihen edhe ekspertë të jashtëm të cilët kontrktohen nëpërmjet kontratave të shërbimit, sipas fushave të tyre të ekspertizës. Evidenca 2.10. Paketa e Instrumentave të cilësisë Evidenca 6.10. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në hartimin e programeve të reja
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Institucioni në këtë kuadër, NJSBC, sipas Ligjit 80/2015, Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, në treguesit e cilësisë të përcaktuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, si dhe në standardet e cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL) ka hartuar një paketë instrumentesh vlerësues, me qëllim vlerësimin periodik të rezultateve të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, burimeve njerëzore, financave, infrastrukturës, marrëdhënieve me publikun, marrëdhënieve ndërkombëtare, aktiviteteve sociale e kulturore, etj. Pyetësorët e studentëve janë një tjetër instrument matës për vlersimin, plotësohen 1 herë në vite përpara sezonit të provimeve, online në mënyrë anonime. NJSBC harton dhe publikon raportet përkatëse të vlerësimit, duke dhënë dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e performancës akademike dhe të cilësisë së programit të studimit. Paketa e instrumenteve të cilësisë për vlerësimin e vazhduar të programeve të studimit i përfshin gjithashtu edhe këto dy pyetësorë. Evidenca 2.10. Paketa e Instrumentave të cilësisë Evidenca 3.11. Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuar sipas rekomandimeve të NJSBC Evidenca 2.8. Paketa e instrumentave të cilësisë. Pyetësor për vlersimin e programit të studimit nga studentët që diplomohen
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes,	Institucioni nëpërmjet NJSBC-ës, vlerëson në mënyrë periodike performancën e personelit dhe merr masa për përmirësimin ose promovimin e tyre. NJSBC ka përgatitur një paketë të gjerë instrumentesh të cilësisë përmes të cilëve vlerëson performancën e personelit akademik në shkallë të

arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	ndryshme të hierarkisë institucionale, duke përfshirë të gjitha kategoritë e personelit akademik. Vlerësimi për performancën e personelit bëhet duke u bazuar në tregues të qartë e të matshëm për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, pjesëmarrjen në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim pasqyrimin e gjendjes reale, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara në aktet rregullatore institucionale. Të dhënat e grumbulluara janë pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë, kryesore dhe institucionale. Mbi bazën e treguesve të performancës dhe të cilësisë, institucioni bën promovime nxitëse për personelin me arritjet më të mira në programin e studimit. Rregullorja parashikon që, nisur nga një performancë e lartë akademike, anëtarët e stafit akademik kanë të drejtë të përzgjidhen për promovim akademik brenda njësisë bazë dhe njësisë kryesore akademike. WBU nxit stafin për kërkim shkencor duke krijuar mbështetje nga institucioni të publikimeve dhe pjesëmarrjes në aktivitete kërkimore shkencore. Në kuadër të aplikimit për projekte me financim kombëtar apo ndërkombëtar, personeli mbështetet në propozimet e tij dhe sipas rastit i vihet në dispozicion një infrastrukturë administrative dhe ndihmës akademike, e cila suporton procesin e aplikimit me informacione, procedura dhe materialet e nevojshme për aplikim. <i>Evidenca 2.10. Paketa e Instrumentave të cilësisë</i> <i>Evidenca 6.1. Formular i vlerësimit të pedagogut nga studentët.</i> <i>Evidenca 6.4. Paketa e instrumenteve të cilësisë. Formular vetëvlersimi të stafit.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka zhvilluar politika dhe procedura të qarta për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, me metoda të ndryshme monitorimi si anketat e studentëve, vlerësimin e pedagogëve dhe sondazhe për punëdhënësit. Rezultatet përpunohen në raporte të detajuara, për të identifikuar arritjet dhe dobësitë dhe për të marrë masa për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</i> <i>IAL bën promovime nxitëse për personelin me arritjet më të mira dhe i ofron personelit mundësinë për të çuar më tej kualifikimet e tyre brenda dhe jashtë vendit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënëit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në këtë proces, NJBSC, njësia kryesore, njësia bazë dhe strukturat drejtuese akademike dhe administrative të institucionit realizojnë evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe hartojnë planin e masave për përmirësim. WBU disponon disa instrumente që përdoren për vlerësimin e programit të studimit. Vlerësimi i performancës së pedagogut nga studentët, vlerësimi i personelit akademik nga përgjegjësi i departamentit, vlerësimi i programit të studimit nga të diplomuarit, vetëvlerësimi i performancës nga vetë personeli akademik, vlerësimi i kolegut nga kolegu. Rezultatet e komponentëve të vlerësimit u bëhen të njohura autoriteteve drejtuese të WBU dhe atyre përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit, të cilët, në rast konstatimi vlerësimi jo të kënaqshëm, marrin masa për përmirësimin e gjendjes. <i>Evidenca 2.10. Paketa e instrumentave të cilësisë</i> <i>Evidenca 6.11. Formular për vlerësimin e personelit akademik nga kolegët</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raportet e vlerësimit të komponentëve të cilësisë, të cilat janë të përfshira në paketën e instrumenteve të cilësisë, përfshijnë vlerësimin e performancës së pedagogut nga studentët, vlerësimin nga kolegët, vlerësimin nga përgjegjësi i departamentit, vetëvlerësimin e performancës, etj. Këto raporte përfshijnë analiza të rezultateve të pritshme dhe rezultateve të vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, si dhe masat e marra për adresimin e mangësive identifikuar. Qëllimi i këtyre raporteve është të sigurohet një përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së programit të studimit. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen në raportet semestrale dhe vjetore të NJSBC dhe u bëhen të njohura autoriteteve drejtuese të WBU dhe atyre përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.

	Motivimi i studentëve me arritje më të larta në procesin mësimor bëhet nëpërmjet aplikimit të bursave në bashkëpunim me institucionet partnere. Evidenca 3.6. Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e mësimdhënies, me performancën e pedagogut, me metodat dhe teknikat e mësimdhënies që ai përdor në auditor, me kurrikulën dhe të mësuarit, me vlerësimet e provimeve apo detyrave të studentëve, të cilat janë pjesë përbërëse e formularit për vlerësimin e performancës së pedagogut nga studentët. Referuar ligjit për arsimin e lartë, vlerësimi i studentëve për personelin e angazhuar dhe lëndët e programit të studimit bëhet 2 herë në vit, një herë në çdo semestër. Vlerësimi i performancës në mësimdhënie i personelit akademik nga studentët bëhet në mënyrë anonime nëpërmjet platformës SMART-WBU. Vlerësimi bëhet nëpërmjet pyetësorëve ku studentët japin përgjigjet për pyetjet e formuluar për vlerësimin e procesit mësimor dhe performancën e personelit akademik. Të dhënat përpunohen në formën e një raporti, i cili u bëhet me dije personelit si dhe publikohet. Evidenca 2.10. Paketa e instrumentave të cilësisë Evidenca 6.4. Paketa e instrumenteve të cilësisë. Pyetësor për vlerësimin e performancës së pedagogut nga studentët
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që	Universiteti “Western Balkans”, në paketën e instrumenteve të cilësisë, përveç vlerësimit periodik, të drejtpërdrejtë, nga studentët për lëndët dhe personelin akademik, ka përcaktuar dhe përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi mbi realizimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. Këto metoda përfshijnë: sondazhe e intervista të studentëve që diplomohen, të atyre të diplomuar, të personelit akademik, ndihmës-akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program. Meqë programi i studimit i ciklit të parë “Bachelor” në “Teknik Laboratori” është në vitin e tretë të tij, vlerësimi i programit në tërësi do të bëhet nga studentët në prag të diplomimit dhe ai i

bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	të diplomuarve dhe partnerëve nga industria e punës do të praktikohet në tre vitet në vijim.			
Konkluzione	<i>Evidenca 6.4. Paketa e instrumenteve të cilësisë. Pyetsor për vlerësimin e programit të studimit nga studentët që diplomohen.</i>			
	<i>Institucioni realizon monitorimin dhe vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit përmes NJSBC dhe strukturave të tjera. Në këtë proces, NJSBC, njësia kryesore, njësia bazë dhe strukturat drejtuese akademike dhe administrative të institucionit realizojnë evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe hartojnë planin e masave për përmirësim. Ky proces ka qëllim arritjen e objektivave të programit dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të studentëve, për t'i përgatitur ata sa më mirë për kërkesat e tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Aktet e brendshme të WBU- garantojnë politika dhe procedura të brendshme të cilësisë, duke krijuar strukturat përkatëse dhe të brendshme, si Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, duke bashkëpunuar edhe me ekspertë të jashtëm. Në proceset e vlerësimit dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë, përfshin të gjitha njësitë akademike dhe përfaqësuesit e studentëve. Pjesë e NJSBC-së janë dhe përfaqësuesit e studentëve. Raportet e NJSBC janë të publikuara dhe lehtësisht të aksesueshme nga të gjithë. Rezultatet e raporteve janë pjesë e planit të punës dhe diskutimeve në departamente.

	<i>Evidenca 3.8. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përherhshëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe me aktet e saj të brendshme. Secila strukturë ka përgjegjësi dhe detyra konkrete të lidhura me vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë. Në WBU funksionon Komisioni i Përherhshëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit dhe është organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik. Komisioni bashkëpunon me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo njësi kryen vlerësime periodike në lidhje me performancën akademike, vlerësimin e studentëve, vlerësimin e personelit akademik, ndihmës akademik apo administrativ. Gjithashtu, në mënyrë periodike vlerëson nevojat e personelit dhe studentëve. <i>Evidenca 3.7. Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përherhshëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit</i> <i>Evidenca 3.9. Vendimi për ngritjen e NJSBC</i> <i>Evidenca 3.10. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë institucioni përfshin të gjitha njësitë akademike dhe përfaqësuesit e studentëve. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja e njësisë bazë, Departamentit të Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazheri, dhe Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, si njësi kryesore, përgjegjëse për programet e studimit. Në këtë vlerësim përfshihen anëtarët e personelit akademik, ndihmës-akademik e administrativ, si dhe studentët në të gjitha programet respektive të studimit. Në paketën e instrumenteve të cilësisë të hartuar nga NJSBC personeli akademik dhe ndihmës-akademik vetë vlerësohet, vlerësohet nga studentët, nga kolegët dhe nga përgjegjësi i departamentit. Përgjegjësi i departamentit vlerësohet nga personeli akademik dhe nga Dekani; Dekani vlerësohet nga Senati Akademik, etj. Kjo garanton një përfshirje të gjerë të gjithë aktorëve dhe faktorëve të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë në institucion. Njësia bazë në hartimin dhe implementimin e programeve të studimit i

	përgjigjet standardeve të cilësisë. Përfaqësuesi i studentëve merr pjesë në mbledhjet e organizuara nga njësia, për transmetimin e mendimit të studentëve dhe përfshirjen e tyre në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit. Pjesë e planit vjetor të NJSBC është edhe monitorimi i cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturës, si një ndër komponentët e vlerësimit të cilësisë. Gjetjet paraqiten në formën e një raporti vjetor, me rekomandimet përkatëse. Evidenca 2.10. Paketa e instrumentave të cilësisë Evidenca 5.28. Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës përfaqësuesin e klasës (Senatorin) e programit të studimit në Njësinë Bazë
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Njësia kryesore dhe njësia bazë, përgjegjëse për programet e studimit përfshihen në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programeve të studimit. NJSBC-ja ka në përbërje të saj përfaqësues nga secila njësi kryesore, përfaqësues të studentëve si dhe ekspertë të jashtëm. Personeli akademik dhe ndihmës-akademik i nënshtrohet vetëvlerësimit, si dhe vlerësimeve nga studentët, kolegët dhe përgjegjësi i departamentit. Departamentet raportojnë në mënyrë periodike dhe vjetore mbi mbarëvajtjen e proceseve të cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës, performancës së studentëve, etj., në njësinë kryesore. Njësia kryesore raporton një herë në vit mbi veprimtarinë e njësisë, bazuar në raportimet periodike dhe vjetore të departamenteve. Evidenca 2.10. Paketa e instrumentave të cilësisë Evidenca 6.14. Raporti vjetor i punës kërkimore-shkencore i Departamentit të Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazherisë 2023-2024 Evidenca 3.6. Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga përfaqësues të çdo njësie kryesore, përfaqësues të studentëve dhe ekspertë të jashtëm. Kjo përbërje garanton përfaqësimin e plotë dhe gjithëpërfshirjen e grupeve të interesit. Ekspertët e jashtëm me eksperiencë, si anëtarë të NJSBC japin mendime të vlefshme mbi cilësinë e programit të studimit dhe përmirësimin e saj. Mund të angazhohen dhe ekspertë të jashtëm në hartimin e kurrikulave, shqyrtimin e literaturës apo propozimet për programet e reja të studimit.

japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.				
Konkluzione	<i>Institucioni përdor mjete të ndryshme për monitorimin e cilësisë, duke përfshirë NjsBC, njësitë akademike, personelin akademik, studentët, si dhe partnerët institucionale. Përmes aktiviteteve të tilla si leksione të hapura me biznese private dhe ekspertë të fushës, si dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, WBU angazhon bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtaria e WBU-së bazohet në një Plan Strategjik Zhvillimi 2023-2030, i cili përputhet me misionin e institucionit. Veprimtaria e institucionit është transparente për personelin, për studentët dhe palët e interesuara. WBU zbaton politika e procedura transparente për sigurimin e cilësisë në programet e studimit që ofron, duke monitoruar dhe vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme programet e studimit. Raportet e NJSBC publikohen dhe janë të aksesueshme në faqen web të institucionit. <i>Evidenca 1.5. Plani Strategjik i Universitetit "Western Balkans" 2023-2030</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	WBU bën publike rezultatet e çdo programi studimi që ofron, pa cenuar lirinë akademike dhe etikën akademike, duke u bazuar në kërkesat e legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat përpunohen në formën e një raporti, i cili edhe publikohet



Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në këtë kuadër të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë në të gjithë komponentët, NJBSC, njësitë kryesore, njësitë bazë dhe strukturat drejtuese akademike dhe administrative të institucionit evidentojnë arritjet dhe dobësitë pas çdo vlerësimi dhe hartojnë planin e masave për përmirësimin e mangësive ose dobësive të evidentuara. Në WBU organizohen trajnime për zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies. Personeli akademik dhe ndihmës-akademik i nënshtrohet kualifikimit dhe trajnimeve të vazhduara edhe për kërkimin shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të aktivitetit akademik.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	WBU vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Institucioni ka strategjinë e tij për të vlerësuar dhe përmirësuar cilësinë e programit të studimit përmes një monitorimi dhe vlerësimi të efektshëm. WBU përdor informacionin dhe analizat e marra nga monitorimet për të identifikuar fushat që kërkojnë përmirësim dhe për të marrë masa për rritjen e cilësisë së programit të studimit. <i>Evidenca 6.5. Plani vjetor i aktiviteteve të departamenti të Shkencave Mjeksore Laboratorike dhe Imazherisë 2023-2024</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në fillim të çdo viti akademik WBU zhvillon një pyetësor në lidhje me nevojat për trajnim të personelit të WBU-së, përmes të cilit mblidhen kërkesat e anëtarëve të personelit të kategorive të ndryshme mbi trajnimet që ata kanë nevojë për gjatë vitit në vijim. Sipas këtyre të dhënave, hartohet plani i zhvillimit të trajnimeve me ekspertë vendas ose të huaj, varësisht temave që trajtohen. Gjatë trajnimeve të zhvilluara në fillim të çdo viti akademik, synohet ndërgjegjësimi i stafit për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Personeli mbështetet në përgatitjen e aplikimeve për Projekte të ndryshme dhe, sipas nevojës, i ofrohet një infrastrukturë mbështetëse administrative dhe ndihmë akademike, mbështet kualifikimet e personelit brenda dhe jashtë vendit. WBU mundëson dhe favorizon integrimin e personelit në jetën sociale, kulturore dhe veprimtari të tjera. IAL garanton angazhimin e rregullt të profesorëve dhe ekspertëve vendas dhe të huaj për të realizuar trajnime dhe programe kualifikimi të vazhdueshëm. Kjo kontribuon në përmirësimin e cilësisë së

	mësimdhënies dhe kërkimit shkencor brenda institucionit . Të gjitha aktivitetet e realizuara kanë qëllim rritjen dhe përmirësimin e cilësisë në të gjitha drejtime në WBU. <i>Evidenca 3.13. Lista e plotë dhe raporti i trajnimeve 2022-2023, 2023-2024</i> <i>Evidenca 6.5. Plan i vjetor i aktiviteteve të departamentit të Shkencave Mjekësore Laboratorike dhe Imazherisë 2024-2025</i> <i>Evidenca 6.9. Model aplikimi për projekt (AKKSHI & QU-SURE)</i>			
Konkluzione	<i>Proceset dhe aktivitetet e realizuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit janë të publikuara dhe transparente, duke siguruar një implementim efektiv të tyre. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin akademik dhe studentët për t'i informuar dhe ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit.</i> <i>WBU mbështet kualifikimet e personelit akademik brenda dhe jashtë vendit, mobilitetet për studentët dhe stafin dhe integrimin e personelit në jetën sociale, kulturore apo veprimtari të tjera gjithëpërfshirëse. Në kuadër të angazhimit ndërkombëtar, institucioni garanton angazhimin e rregullt të profesorëve dhe ekspertëve vendas dhe të huaj për të realizuar trajnime dhe programe kualifikimi të vazhdueshëm. Këto iniciativa ndikojnë në rritjen e performancës së personelit akademik dhe administrativ, duke siguruar përditësimin e njohurive dhe aftësive të tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kjo strategji kontribuon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor brenda institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknik Laboratori” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Western Balkan”.

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Struktura e programit dhe kurrikula bashkëkohore e përshtatur me tregun shqiptar e më gjerë si dhe ofrimi i programit në dy gjuhë.
2. Struktura e re, me hapësira komode, që plotëson kushtet e mësimdhënies për këtë program studimi.
3. Laboratorë të dedikuar për lëndët specifike të programit të studimit të paisura me mjete didaktike dhe laboratorike bashkëkohore.
4. Përdorimi i infrastrukturës së avancuar IT në shërbim të mësimdhënies dhe proceseve administrative duke kontribuar në shërbim të shpejtë dhe transparent për studentin.
5. Mundësia e praktikave spitalore (bashkëpunimi i ngushtë me stuktura spitalore) dhe programi EPIC krijon premisat e të mësuarit duke punuar, një risi në sistemin universitar shqiptar.
6. Bashkëpunimi me institucione shqiptare dhe të huaja në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Pika të dobta:

1. Numri i kufizuar i pedagogëve me grada e tituj shkencorë. [(Standarti III.1/ Kriteri 4); (Standarti II.3/ Kriteri 4)]
2. Struktura e kampusit e vendosur larg qytetit në autostradë mund të ndikojë në frekuentimin e studentëve. [(Standarti IV.2/Kriteri 1)]
3. Pedagogë që japin më shumë se tre lëndë dhe ndonjëherë jashtë profilit të specialitetit të tyre. [(Standarti III.1/ Kriteri 4)]

Rekomandime:

1. Përshtatja e ngarkesës sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin 29 të MASR, datë 10/09/2018.
2. Rritja e numrit të pedagogëve me tituj dhe grada në këtë program studimi. [(Standarti III.1/ Kriteri 4)]
3. Shtimi i aplikimeve për projekte shkencore.



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Bachelor in "Laboratory Technician" provided by the Higher Education Institution "University of "Western Balkan".

Strengths and affirmations:

1. Program structure and contemporary curriculum adapted to the Albanian market and beyond, as well as offering the program in two languages.
2. New structure, with comfortable spaces, that meets the teaching conditions for this study program.
3. Laboratories dedicated to specific subjects of the study program equipped with modern didactic and laboratory tools.
4. Use of advanced IT infrastructure in the service of teaching and administrative processes, contributing to fast and transparent service for the student.
5. The possibility of hospital internships (close cooperation with hospital structures) and the EPIC program creates the premises of learning by doing, an innovation in the Albanian university system.
6. Cooperation with Albanian and foreign institutions in the field of teaching and scientific research.

Weaknesses:

1. Limited number of faculty with scientific degrees and titles. [(Standard III.1/ Criterion 4); (Standard II.3/ Criterion 4)]
2. Campus structure located far from the city on the highway may affect student attendance. [(Standard IV.2/ Criterion 1)]
3. Faculty teaching more than three subjects and sometimes outside their specialty profile. [(Standard III.1/ Criterion 4)]

Recommendation:

1. Adaptation of the workload according to the requirements set out in Law 80/2015 “On Higher Education in the Republic of Albania” and Instruction 29 of the MASR, dated 10/09/2018.
2. Increasing the number of lecturers with titles and degrees in this study program. [(Standard III.1/ Criterion 4)]
3. Increasing applications for scientific projects.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

